


RAPORTI I PROGRESIT

Zbatimi afatmesëm i strategjisë për avancimin e të
drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022–2026
dhe planit të veprimit 2022–2024



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit/ Kancelarija Premijera/ Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office of Good Governance



Titulli:

RAPORTI I PROGRESIT

Zbatimi afatmesëm i strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022–2026 dhe planit të veprimit 2022–2024

Publikuar nga:

Programi i Integritetit të Romëve, Faza III
Divizioni i Romëve dhe Udhëtarëve
Këshilli i Evropës
Avenue de l'Europe
F-67000 Strasbourg
www.coe.int/roma-integration

Përgjegjësia:

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.
Të gjitha kërkesat për riprodhimin ose përkthimin, të plotë apo të pjesshëm, të këtij dokumenti duhet të drejtohen te Programi i Integritetit të Romëve – Faza III (roma.team@coe.int).

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

RAPORTI I PROGRESIT

Zbatimi afatmesëm i strategjisë për avancimin e të
drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022–2026
dhe planit të veprimit 2022–2024

**Republika e Kosovës, Qeveria,
Zyra e Kryeministrit,
Zyra për Qeverisje të Mirë**

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	7
1 Hyrje	9
2 Pikat e kontaktit për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022–2026.	11
3 Metodologjia e raportit	12
4 Zbatimi, mbikëqyrja dhe periudha e raportimit	13
5 Paraqitja e disa të arriturve në fushat e planit të veprimit përmes statistikave	14
6 Zbatimi i planit të veprimit në fushën e arsimit dhe progresi	17
6.1.SFIDAT NË ZBATIM	20
6.2.REKOMANDIMET	21
7 Zbatimi i planit të veprimit në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale	23
7.1.SFIDAT NË ZBATIM	28
7.2.REKOMANDIMET	28
8 Zbatimi i planit të veprimit në fushën e shëndetësisë	30
8.1.SFIDAT NË ZBATIM	34
8.2.REKOMANDIMET	34
9 Zbatimi i dhe planit të veprimit në fushën e banimit	36
9.1.SFIDAT NË ZBATIM	37
9.2.REKOMANDIMET	38
10 Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit në fushën mbrojtjes nga diskriminimi	39
10.1.SFIDAT NË ZBATIM	43
10.2.REKOMANDIMET	43
11 Ndikimi i dhe planit të veprimit në avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Kosovë dhe ndërlidhja me deklaratën e Poznanit	44

Lista e shkurtimeve

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
APRK	Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës
ARC	Agjencioni i Regjistrimit Civil
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEB	The social development bank for Europe
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
KKV	Komiteti Komunal i Veprimt
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
KPSHSF	Këshilli i Prishtinës për Shërbime Sociale dhe Familjare
LMD	Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata jo-qeveritare
OSBE	Organization for Security and Cooperation in Europe
QAP	Qendrat për Aftësim Profesional në Kosovë
QAP	Qendrat për Arsim dhe Aftësim Profesional
QKMF	Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare
QKSF	Qendrat Kryesore të Shëndetësisë Familjare
QPS	Qendrat për Punë Sociale

RCC	Regional Cooperation Council
SFFAKP	Skema e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme
SIMP	Sistemi Elektronik i Ministrisë së Punës
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve të Arsimit
SNS	Skemat e ndihmës sociale
UA	Udhëzimin Administrativ
UNDP	United Nations Development Programme
VoRAE	Voice of Roma, Ashkali and Egyptians
WBIF	Western Balkans Investment Framework
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
ZQM / ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit

1 Hyrje

Ky Raport afatmesëm është hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM ZKM) për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024 si dhe përfshin periudhën e zbatimit për vitet 2022-2024.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit sipas mandatit të saj ka një rol të rëndësishëm në koordinimin e zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit. Hartimi i këtij raporti është mbështetur nga projekti "Integrimi i Romëve III", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Për herë të parë, raporti vjetor për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024 është hartuar për vitin 2022, më pas i njëjti në vitin 2023. Ky raport afatmesëm, përfshin vitet e zbatimit të planit të veprimit në tre (3) vite, respektivisht 2022, 2023 dhe 2024.

Raporti paraqet gjendjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare përmes vlerësimit të zbatimit të aktiviteteve të dhe Planit të Veprimit, për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe të përmirësimit të gjendjes dhe situatës arsimore, socio ekonomike, kulturore, shëndetësore të tyre.

Më 20 korrik 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 89-të të saj, miratoi **Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024**.

Strategjia ka si objektiv rritjen efektive të ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës; rritjen e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe uljen e varfërisë; përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore; rritjen e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike dhe parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykitimeve, stereotipeve dhe bullizmit për komunitetin rom dhe ashkali. Ndër të tjera, Strategjia dhe plani i veprimit, synojnë të zbatojnë zotimet që kanë dalë në deklaratën e Poznan-it, me qëllim të integritit të romëve,

në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së. Strategjia dhe plani i veprimit gjithashtu është hartuar në bazë të Kornizës BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat adresohen në Strategji: **arsimi, punësimi, mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi**.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit është një çështje kyçe për të siguruar një pasqyrë për gjendjen e komuniteteve rom dhe ashkali dhe relacion me institucionet e Kosovës në pesë fushat e përcaktuara. Të gjitha institucionet qeveritare, qendrore dhe lokale, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre, obligohen të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali për vitin 2022-2026 dhe si rrjedhojë edhe të Planit Veprimit 2022-2024. Pjesë e rëndësishme e monitorimit të zbatimit është edhe monitorimi i zbatimit të Planeve Lokale të Veprimit (PLV).

Buxheti është një ndër aspektet e rëndësishme të zbatimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024. Institucionet e Kosovës me aprovimin e Planit të veprimit janë zotuar për ndarjen e buxhetit, i cili është i bazuar në përcaktimet e planit të veprimit.

Raporti afatmesëm për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komunitetit rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024, përmes raportimit të të dhënave nga institucionet kompetente, pasqyron gjendjen dhe mënyrën se si është zbatuar Strategjia dhe Plani i veprimit dhe se sa është arritur efekti i zbatimit të saj në avancimin e të drejtave të këtyre komuniteteve, në vitet 2022, 2023, 2024.

Raporti ka për qëllim po ashtu që të vë në pah aktivitetet që janë ndërmarrë dhe vazhdojnë të ndërmerren në drejtim të realizimit të objektivave të përmbajtura në pesë fusha të për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024, në fushat arsim, punësim, mirëqenie sociale, shëndetësi, banim dhe në fushën e luftimit të diskriminimit. Gjithashtu, synimi i këtij raporti, përveç vlerësimit që është bërë në pesë sektorë në bazë të objektivave të Planit të

veprimit, lidhet edhe me identifikimin e problemeve, sfidave në zbatimin e aktiviteteve të përfshira në Plan të veprimit.

Përmbushja e qëllimit të këtij raporti, si dhe çështjet e identifikuara në të dhe raportet e kaluara, mund të shërbejnë si udhërrëfyes për të identifikuar aspektet e rëndësishme që kanë të bëjnë me avancimin e të drejtave të komunitetit rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij raporti, po ashtu jetësohet edhe nën dritën e zotimeve të deklaratës së Poznan-it dhe synon të nxjerr në pah punën e institucioneve të Kosovës, në drejtim të përmbushjes së zotimeve që dalin nga deklaratata e Poznan-it.

2 Pikat e kontaktit për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022–2026.

Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe plani i veprimit 2022-2024, ka përcaktuar procesin e monitorimit. Po ashtu edhe raportimi është pjesë e rëndësishme e kësaj Strategjie, me qëllim të tregimit dhe paraqitjes së të dhënave reale për zbatimin e këtij dokumenti.

Në lidhje me monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit, ndër të tjera në f.59 të saj përcaktohet *“Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë zbatimit të Strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimet e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga ZQM në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesit”*.

Zyrtari përkatës i komunës është personi kontaktues në komunë për komunikim, ndërmjet komunës dhe ZQM/ministrive të linjës për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Planit të Veprimit në nivel qendror. Për aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit të nivelit qendror që do të zbatohen nga ministrinë e linjës në komuna, Zyrtari përkatës i komunës ka lehtësuar komunikimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse komunale dhe ministrisë dhe do të jetë pjesë e çdo korrespondence të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve komunale dhe ministrisë për çështje të tilla.

Pikat e kontaktit dhe Ministrinë Kryesore, me të cilat është punuar dhe janë zhvilluar takime të vazhdueshme, për zbatimin e planit të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë: MASHTI MSH; MMPHI; MPFT; APRK; IKAP; AKSP; ABGJ; MK; Komunitatet përmes ministrive të linjës. ZQM, ka zhvilluar takime të vazhdueshme me pikat e kontaktit, gjatë tri viteve të përmbushjes së planit të veprimit.

3 Metodologjia e raportit

Raporti për zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali ndjek metodologjinë e një strukture të njëjtë me Strategjinë, duke ofruar të dhënat që identifikojnë zbatimin e këtij dokumenti, në fushën e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Këto të dhëna janë të paraqitura në raport, në formë narrative ose sasiore si dhe në formë statistikore, sipas objektivave Strategjike dhe objektivave specifike të strategjisë dhe planit të veprimit.

Raporti është hartuar mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga institucionet qendrore dhe institucionet e nivelit lokal. Për zbatimin dhe për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 si dhe planit të veprimit 2022-2024, janë mbledhur të dhënat nga: **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MM-PHI), Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), disa nga Komunitatet përkatëse si dhe Agjencioni i Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK); në disa raste disa komuna dhe institucione të tjera, siç janë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Akademia e Drejtësisë (AD), Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) etj.**

Të dhënat e paraqitura në këtë raport, janë të dhëna dhe informata të pranura zyrtarisht nga Institucionet e Kosovës. Për hartimin e raportit në fjalë, nuk është përdorur ndonjë metodologji e atillë e referencimit të dokumenteve të jashtme ose raporteve të tjera, për faktin se raporti është shkruar, sipas raportimit të të dhënave zyrtare nga pikat e kontaktit.

Struktura e trajtimit të të dhënave të mbledhura, është ndërtuar në mënyrën si në vijim:

1. Është raportuar për secilën fushë që është pjesë e avancimit të të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-20226 dhe planit të veprimit 2022-2024;
2. Struktura dhe raportimi i të dhënave janë të lidhura me objektivat Strategjike dhe objektivat specifike të bazuar edhe në aktivitetet e planit të veprimit;
3. Janë raportuar dhe elaboruar aktivitete të tjera që ndërlidhen me objektivat e Strategjisë dhe planit të veprimit të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, në zbatimin e planit të veprimit të saj;
4. Janë dhënë rekomandime të caktuara, kryesisht ndërlidhura me dimensionin e mospërbushjes së objektivave të caktuara ose përmirësimit të zbatueshmërisë së planit të veprimit;
5. Janë paraqitur sfidat të cilat janë shënuar vetëm në rastet e moszbatimit të planit të veprimit;
6. Në fund të secilit aktivitet është dhënë një konkluzion për nivelin e përbushjes së aktivitetit si: "i përbushur", "i përbushur pjesërisht" etj. Konkluzioni është bazuar në gjykimet reale të dëshmimeve të raportimit.
7. Për secilën fushë të zbatimit, janë dhënë rekomandimet.
8. Mbledhja e të dhënave është realizuar nga ZQM/ZKM në bashkëpunim të ngushtë me institucionet respektive, ku janë zhvilluar takime si dhe konsulta përmes formave të ndryshme. Të dhënat e pasqyruara në kuadër të këtij raporti, sipas sqarimit të dhënë nga institucionet përveç komuniteteve rom dhe ashkali, përfshijnë edhe komunitetet egjiptian në Republikën e Kosovës.

4 Zbatimi, mbikëqyrja dhe periudha e raportimit

Për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-20226 dhe planit të veprimit 2022-2024, janë paraqitur të gjitha veprimet e institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse duke u bazuar në planin e veprimit.

Raportimi i institucioneve përkatëse, ministrive dhe agjencive të caktuara, nën mbikëqyrjen e ZQM është bërë ndër vite dhe ato të dhëna janë përmbledhur në këtë raport. Raporti paraqet të dhënat në bazë të indikatorëve të shënuar në planin e veprimit 2022-2024 si dhe raportimet që janë bërë.

Mbledhja e të dhënave për zbatimin e planit të veprimit është bërë përmes institucioneve si dhe në punëtorinë e mbajtur me 17-19 Dhjetor 2024, në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha institucionet (pikat e kontaktit) që raportojnë në vazhdimësi. Punëtorja është mbështetur nga KFOS.

Megjithatë, në formën narrative, për secilën fushë është raportuar, bazuar në aktivitetet e planit të veprimit dhe në rast se ka pasur sfida në zbatim ose mos zbatim të aktiviteteve, janë paraqitur rekomandime për secilën fushë.

Paraqitja e të dhënave në strukturën e raportit është bërë në atë mënyrë ku për secilin aktivitet është treguar raportimi, në vitin 2022, 2023 dhe 2024. Kështu, lexuesi do të ketë mundësinë të krahasojë të dhënat ndër vite të progresit në zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit. Megjithatë, krahasimi është reflektuar edhe në paraqitjen statistikore të raportit afatmesëm.

Raportimet e të dhënave dhe mbikëqyrja është bërë për tri (3) komunitetet, rom, ashkali dhe egjiptian.

5 Paraqitja e disa të arriturave në fushat e planit të veprimit përmes statistikave

Në pjesën vijuese janë paraqitur disa të arritura kryesore në fushat e zbatimit, të shprehura në statistika. Megjithatë, në të gjitha rastet ka qenë e pamundur të gjenerohen statistikat, për shkak se veprimet në përbushjen e Strategjisë dhe planit të veprimit, është dashur edhe të përshkruhen në mënyrë narrative dhe jo vetëm statistikore.

FUSHA E ARSIMIT

Regjistrimi i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet shkollore publike:

- 2022-6362 nxënës;
- 2023-6434 nxënës;
- 2024-6049 nxënës;

Organizimi i mësimin në gjuhën rome për vitet 2022-2024:

- 210 nxënës, në tri komuna (Prizren, Podujevë, Novobërdë)

Ndarja e bursave për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

- Viti 2022-498 dhe 26 studentë;
- Viti 2023-467 nxënës dhe 55 studentë;
- Viti 2024-417 bursa për studentë;

Mentorimi i studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

- Viti 2022-600 nxënës
- Viti 2023-Nuk ka shifër të përgjithshme të raportuar
- Viti 2024-100 studentë

Përfitimi nga rimbursimi i teksteve shkollore për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

- Në vitin 2024 kanë përfituar nga rimbushim 5729 nxënës

Regjistrimi i qendrave mësimore

- Deri në vitin 2024 rezultojnë 56 qendra të regjistruara dhe 9 në proces të regjistrimit

Mbështetja e qendrave mësimore

- Viti 2022-200,000 Euro të ndara nga MASHT në vitin 2022, 14 OJQ që mbajnë qendra të mbështetura
- Viti 2023-200,000 Euro të ndara nga MASHT në 2023, 7 OJQ përfituese, me gjithsejtë 21 qendra mësimore
- Viti 2024-250,000 Euro të ndara nga MASHT në 2024, 9 OJQ përfituese me 30 qendra mësimore

Organizimi i fushatave për vetëdijësimin e prindërve rom dhe ashkali lidhur me rëndësinë dhe mundësitë e edukimit në fëmijërinë e hershme:

- Në tri vite (2022,2023,2024) janë raportuar 8 sesione informuese, në 7 komuna dhe 7 qendra mësimore

PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE

Nxitja e regjistrimit dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale konform nevojave të tregut të punës

- Në vitin 2022 janë përfshirë në trajnime 104 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- Në vitin 2023 janë përfshirë në trajnime 57 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- Në vitin 2024 janë përfshirë në trajnime 24 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Numri i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian i përfshirë në subvencionim në pagë

- Viti 2022-26 persona
- Viti 2023-23 persona
- Viti 2024-16 persona

Angazhimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në praktikë, në punë dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal

- Viti 2022-3 persona
- Viti 2023-10 persona
- Viti 2024-2 persona

Rritja e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërmjetësimit në punësim

- Viti 2022-55 përfitues
- Viti 2023-104 përfitues
- Viti 2024-99 përfitues

Mbështetja Financiare për komunitetet rom dhe ashkali përmes përfshirjes në Skemat e Mirëqenies Sociale

- Viti 2022-52 fëmijë në strehim familjar dhe alternativ; 113 fëmijë janë mbështetur me pagesë 100 euro nga skema e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Viti 2023-79 fëmijë në strehim familjar dhe alternativ; 122 fëmijë janë mbështetur me pagesë 100 euro nga skema e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Viti 2024-74 fëmijë në strehim familjar; 130 fëmijë janë mbështetur me pagesë 130 euro nga skema e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Ofrimi i ndihmave sociale për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali përmes Skemës së Ndihmave Sociale

- Viti 2022-3000 familje me 14, 100 anëtarë janë përfitues
- Viti 2023-2,820 familje me 12,247, anëtar/e të familjes janë përfitues
- Viti 2024-2,637 familje me 12,294, anëtarë të familjes janë përfitues

Përfituesit e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga Skemat Emergjente sipas familjeve

- Viti 2022-39 familje
- Viti 2023-19 familje
- Viti 2024-8 familje

FUSHA E SHËNDETËSISË

Ofrimi i mamografisë mobile në 5 komuna për gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

- Viti 2022-Kanë përfituar 24 gra
- Viti 2023-Kanë përfituar 46 gra
- Viti 2024-Kanë përfituar 86 gra

Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme

- Viti 2022-Kanë përfituar 3288 persona
- Viti 2023-266 persona, vetëm në 3 (tri) komuna
- Viti 2024-1242 persona që kanë përfituar në disa komuna

Pjesëmarrja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në vaksinimin e fëmijëve

- Në vitin 2022 përmes fushatës derë më derë, janë vaksinuar gjithsejtë 14664
- 237 fëmijë të vaksinuar përmes QKMF-ve

Ligjërata ndërgjegjësuere për promovim shëndetësor dhe parandalimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse, ushqyeshmëri

- Viti 2022-Nuk ka raportime të sakta
- Viti 2023-Të raportuara 24 ligjërata ndërgjegjësuere
- Viti 2024-Të raportuara 92 ligjërata ndërgjegjësuere

FUSHA E BANIMIT

Ngritja e kapaciteteve të Komunave për përdorimin e platformës elektronike me të dhënat për banim social.

- Aktiviteti për avancimin e platformës përfshinë 100.000 euro të ndara në vitin 2025

Personat nga radhët e komuniteteve, rom, ashkali dhe egjiptian që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga ANJF

- 2022-428 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- 2023-508 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- 2024-420 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Përkrahja në renovimin, rindërtimin dhe sigurimin e materialeve ndërtimore të shtëpive në nevojën për parcelat vetanake të komuniteteve rom dhe ashkali.

- Nga 1 milion euro të ndara për banim social kanë përfituar, 10 rom, 10 ashkali dhe 20 egjiptian.

Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në vendbanimet e komuniteteve rom dhe ashkali, ku përcaktohen nevojat e tilla nga studimi i fizibilitetit.

- 107 shtëpi janë ndërtuar dhe 75% të përfituesve në këtë kategori janë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

MBROJTJA DHE LUFTIMI I DISKRIMINIMIT

Identifikimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit.

- Janë mbajtur trajnime për "Hyrje në Antigjipsizëm", i cili i është dedikuar zyrtarëve publik.

Zhvillimi i kapaciteteve, ofrimi i trajnimeve themelore, të avancuara dhe të specializuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe racizmit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali për: Policinë e Kosovës; Shërbimin Korrektues; Shërbimin Sprovues; Doganën e Kosovës; Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; Inspektoratin Policor të Kosovës si dhe personat privat fizik dhe juridik

- Në vitin 2022: AKSP ka realizuar trajnime me 6 tema të ndryshme me 597 pjesëmarrës.

- 2023: Pjesëmarrës në trajnime në: Policinë e Kosovës me gjithsejtë shtatë (7) rom dhe ashkali, ndërsa tre (3) janë të komunitetit egjiptian, kurse Shërbimin Korrektues të Kosovës me një (1) pjesëtar nga komuniteti egjiptian.

- 2024: Gjithsejtë 28 pjesëmarrës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në trajnimet e fushëveprimtarisë policore, në trajnimin "Zyrtar Policor".

Obligimi për krijimin e platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

- Platforma kombëtare është krijuar në vitin 2022 dhe vazhdon së ekzistuari me mbështetjen e partnerëve përmes ZQM-së.
- Në platformën kombëtare deri në dhjetor 2024 janë raportuar 52 raste të diskriminimit dhe jenë trajtuar me sukses 18 raste

Grupi Teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

- Në vitin 2022 ka mbajtur 3 takime
- Në vitin 2023 ka mbajtur 3 takime
- Në vitin 2024 ka mbajtur 4 takime

Krijimi i grupit punues për martesat e hershme

- Për të luftuar këtë dukuri negative në shoqëri, është themeluar Grupi Punues ndërinstitutional për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme në komunitet rom, ashkali dhe egjiptian me Vendimin e Qeverisë nr. 41/178 të datës 13.12.23

6 Zbatimi i planit të veprimit në fushën e arsimit dhe progresi


Në kuadër të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 2022-2025 dhe planit të veprimit, fusha e arsimit identifikon këto objektiva specifike: **Vetëdijesimi dhe promovimi i rëndësisë së arsimit dhe përfshirjes së fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë; Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim; Luftimi i diskriminimit, racizmit, stigmatizimit, gjuhës së urrejtjes, dhunës së urrejtjes dhe bullizmit në shkolla dhe promovimi i kulturës dhe historisë së komuniteteve rom dhe ashkali;**

1. Lidhur me aktivitetin e monitorimit dhe implementimit të udhëzimit administrativ për lehtësimin e kriterëve për regjistrim të fëmijëve rom dhe ashkali në institucione parashkollore publike: është realizuar monitorimi i zbatimit të udhëzimit administrativ për lehtësimin e kriterëve për regjistrim të fëmijëve rom dhe ashkali në institucione parashkollore publike. Sipas të dhënave nga monitorimi i zbatimit të këtij udhëzimi dhe të dhënave të paraqitura nga sistemi i MASHTI, SMIA, në vitin 2022-2023, numri i nxënësve të regjistruar nga komunitetet rom ashkali është **6362 nxënës (rom 1039, ashkali 3965 dhe egjiptian 3306)**. Kurse ky numër në vitin 2023-2024 është **6434** (rom, 1157 ashkali 4000, egjiptian, 4000), kurse për vitin 2024-2025 është

6049 (rom 875, 3702 ashkali, 1472 egjiptianë. Konkluzioni: Aktiviteti është i përbushur.

2. Parandalimi i braktisjes së shkollave nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është një çështje me rëndësi dhe për këtë arsye kanë funksionuar ekipet për parandalimin e braktisjes në shkollë (EPRMD). Në vitin 2022 Ekipi qendror për parandalimin e braktisjes, në bashkëpunim me OJQ ka arritur të parandaloj braktisjen nga shkolla të pesë (5) nxënësve në komunën e Prizrenit. Në vitin 2023 MASHTI ka përkrahur funksionimin e ekipeve dhe hartimin e planeve komunale për 15 komuna, si dhe ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme rekomandime specifike për rastet e identifikuara, për sa i përket parandalimit dhe braktisjes në shkolla. Lidhur me përbushjen e këtij aktiviteti MASHTI ka ofruar disa module si në vijim: *Parandalimi i diskriminimit në shkolla; Promovimi i barazisë gjinore; Parandalimi i gjuhës së urrejtjes; Parandalimin e dhunës në familje; Parandalimin e trafikimit të fëmijëve; Parandalimi i ngacmimeve seksuale; Programi i iniciativës së të rinjve – “Y Rinia” dhe Parandalimi i martesave të hershme; Parandalimi i punës së fëmijëve.* Në vitin 2024, MASHTI nuk ka raportuar për këtë aktivitet me shifra konkrete lidhur me braktisjen. Megjithatë, në muajin Nëntor 2024, MASHTI ka filluar me hartimin e udhëzuesit për parandalimin e martesave të hershme. Këta udhëzues do t'i dedikohen prindërve, shkollave dhe OJQ-ve. **Konkluzioni: Aktiviteti konkret**

Nr. i nxënësve sipas përkatësisë etnike



është përmbushur në 2022, 2023 kurse në 2024 nuk ka raportim.

3. **Organizmi i mësimi plotësues në gjuhën rome është zbatuar pjesërisht, përkundër gadishmërisë së MASHTI për mbështetje.** Në vitin 2022, vetëm komuna e Prizrenit kishte aplikuar për mësim plotësues në lëndë përkatëse në gjuhën rome. Ndërkaq, në vitin 2023 gjendja ka qenë më e kënaqshme. Kështu, në vitin 2023 mësimi plotësues në gjuhën rome vazhdoi të organizohet në komunën e Prizrenit, respektivisht në katër shkolla ku kanë marrë pjesë 100 nxënës. Po ashtu, më 2023 është raportuar që komuna e Novobërdës ka angazhuar mësim plotësues në gjuhën rome ku janë angazhuar 13 nxënës, 7 djem dhe 6 vajza, si dhe 2 mësimdhënës. Mësim plotësues për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali ka organizuar edhe komuna e Podujevës, ku kanë qenë të përfshirë 97 fëmijë, respektivisht 62 djem dhe 35 vajza si dhe 4 mësimdhënës. Në vitin 2024, mësimi i gjuhës rome ka vazhduar të organizohet në komunën e Prizrenit në katër shkolla, ku marrin pjesë rreth 100 nxënës. Nuk ka informacione për realizimin e mësimi në më shumë se një komunë. **Konkluzioni: Aktiviteti nuk është përmbushur plotësisht në 4 komuna.**

4. **Ndarja e 500 bursave, për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali:** Në vitin 2022, 498 bursa janë ndarë për nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët kanë plotësuar kriteret. Shuma e ndarë gjithësej është 149.400.00 euro. Po ashtu, kanë përfituar edhe 26 studentë të regjistruar në vitin e parë të studimeve të cilëve MASHTI ju ka ndarë bursa në vlerë prej 1000 euro për student, shuma totale 26.000 euro. Në vitin 2023 MASHTI ka planifikuar 500 bursa në vlerë 150.000 euro ndërsa për vitin shkollor 2023/24 kanë përfituar 467 nxënës. Po ashtu, gjatë vitit 2023, për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë ndarë 55 bursa përmes marrëveshjes në mes MASHTI dhe MAPL-së. Monitorimi për këta student do të zhvillohet nga VORAE-se, Roma Versitas dhe bashkëpunim me Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren. Në vitin 2024 janë ndarë 417 bursa. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

5. **Mentorimi i 50 studentëve nga radhët e komuniteteve, ka vazhduar:** Kështu, në vitin 2022 Projekti INCLUDE ka ndarë grante për dy (2) OJQ të cilët kanë bërë mentorimin e 600 nxënësve të shkollave të mesme të larta duke përfshirë

edhe përfituesit e bursës nga MASHTI. Në vitin 2023, sipas të dhënave të MASHTI, mentorimi i studentëve nga radhët e komuniteteve është realizuar nga OJQ Roma Versitas Kosova. Nga raportimi që ka ardhur nga komunat, përveç kësaj të dhënë të pranuar nga MASHTI, rezultoi që 20 persona të komunitetit ashkali, 2 të komunitetit Egjiptian dhe 5 të komunitetit rom, kanë përfituar nga mentorimi në komunën e Podujevës. Në vitin 2024, mentorimi i studentëve u realizua nga OJQ VORAE, ku është bërë mentorimin 110 studentëve (të gjithë studentë aktiv). **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

6. **Promovimi për mundësitë e arsimimit dhe aftësimi profesional (materiale promovuese), për orientimin në karrierë për nxënës të klasave të 9-ta:** Në vitin 2022 MASHTI ka organizuar fushatë për orientim në karrierë e cila organizohet çdo vit shkollor. Gjatë vitit 2023 janë bërë planifikime lidhur me fushatë vetëdijësuese nga Save the Children. Në vitin 2024 ka filluar implementimi i projektit **"Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës"**, i cili ka për qëllim të mbështesë këto komunitete në arsim dhe aftësim profesional dhe nxënës të klasave 6-9 për orientim në karrierë. Në 2025 planifikohet mbështetje financiare nga projekti për nxënës të arsimit të obligueshëm për klasat 6-9 dhe për nxënës të shkollave të mesme profesionale: *Ofrimi i ndihmës financiare për 300 nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë që janë në rrezik për ta braktisur shkollimin nga shkollat e mesme të ulta për arsye financiare dhe ofrimi i ndihmës financiare për 150 nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë që janë në rrezik për të braktisur shkollimin nga shkollat profesionale për arsye financiare.* **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht vetëm në vitin 2024-2025.**

7. **Sigurimi i materialeve shkollore për nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rastet sociale, është realizuar me ndihmën e MASHTI:** Në vitin 2022 MASHTI ka ofruar tekste shkollore falas për të gjithë nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në vitin 2023, respektivisht për vitin shkollor 2023/2024 ka rimbursuar me mjete financiare prindërit për të siguruar tekstet shkollore dhe mjetet mësimore për klasat 1-5 dhe 6-9, për nxënës të arsimit të detyrueshëm. Për klasat 1-5 janë rimbursuar nga 50 euro për nxënës dhe për klasat 6-9 janë rimbursuar

nga 30 euro për mjete mësimore. Në këtë rast, kanë përfituar edhe fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali. Në vitin 2024, MASHTI ka rimbursuar me mjete financiare prindërit për të siguruar tekstet shkollare dhe mjetet mësimore për klasat 1-9. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

8. Mbështetja në regjistrimin e 20 qendrave mësimore:

Gjatë vitit 2022, janë regjistruar edhe 20 qendra mësimore dhe deri në vitin 2022 kanë qenë të regjistruara gjithsej 38 qendra mësimore. Deri në vitin 2023, 52 qendra mësimore kanë qenë të regjistruara. Nga dhjetori i vitit 2023, kanë filluar të aplikojnë rreth 21 qendra mësimore për ri-regjistrim. Po ashtu, në vitin 2023 janë mbështetur 4 qendra mësimore për komunitetet rom dhe ashkali në komunën e Podujevës. Në vitin 2024, ka rezultuar se 56 qendra janë regjistruar, kurse 9 janë në proces të regjistrimit. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

9. Mbështetja e 30 qendrave mësimore të regjistruara në bazë të udhëzimit administrativ:

Për vitin 2022, MASHTI ka ndarë buxhet në vlerë prej 200.000 euro për mbështetjen e OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore të cilat mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në bazë të thirrjes për financimin e OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore, kanë aplikuar 15 OJQ dhe fituese janë shpallur 5, me 14 qendra mësimore që i kanë plotësuar kriteret. Në vitin 2022, gjithashtu edhe përmes projektit INCLUDE janë ndarë grante për OJQ për organizimin e shkollave verore dhe dimërore për nxënësit e këtyre komuniteteve. Në vitin 2023, sipas Udhëzimit Administrativ 19/2018 ka shpallur thirrje për financimin e OJQ-ve që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që kontribuojnë në arritjen arsimore. Buxheti i planifikuar ka qenë në vlerë prej 200.000.00 euro. Në këtë thirrje kanë përfituar 7 OJQ, me gjithsej 21 qendra mësimore. Për vitin 2024, MASHTI ka shpallur thirrje për financimin e OJQ-ve që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe të tjerë, që kontribuojnë në arritjen arsimore. Buxheti i planifikuar ka qenë në vlerë prej 250.000.00 euro. Në këtë thirrje kanë përfituar 9 OJQ, me gjithsej 30 qendra mësimore. Buxheti i planifikuar për këtë thirrje është ndarë – shpenzuar në tërësi. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

10. Lidhur me rishikimin e planprogrameve, teksteve ekzistuese të gjuhës rome dhe harti-mi i teksteve të reja në gjuhën rome: Në vitin 2022 është mbajtur një takim me përfaqësues të komunitetit rom dhe njohës të gjuhës rome lidhur me planprogramet dhe tekstet ekzistuese të gjuhës rome. Në vitin 2023, sipas të dhënave nga MASHTI, ky proces nuk ka filluar ende për arsye se ka qenë e planifikuar të filloj në vitin 2024 me mbështetjen e Këshillit të Evropës (KiE) me projektin e ri katër (4) vjeçar. Nuk ka akoma një datë të saktë se kur do të fillojë saktësisht ky projekt. Në vitin 2024, MASHTI ka mbajtur punëtori tre ditore për shqyrtimin e kërkesave që dalin për rishikim të planprogrameve dhe teksteve të gjuhës dhe kulturës rome. **Konkluzioni: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**

11. Organizimi i fushatave për vetëdijesimin e prindërve rom dhe ashkali lidhur me rëndësinë dhe mundësitë të edukimit në fëmijërinë e hershme: Në vitin 2022 janë realizua takime që raportojnë për lehtësimet që i ofron UA në fuqi, për regjistrimin e fëmijëve rom dhe ashkali në institucionet parashkollore. Në vitin 2023 janë organizuar 4 sesione informuese me prindërit e komuniteteve për lehtësimet që ofrohen me UA për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, me qëllim të informimit për të drejtat që i kanë komunitetet rom dhe ashkali, në institucionet parashkollore. Sesionet janë mbajtur në 3 komuna, Fushë Kosovë, Gjakovë dhe Ferizaj. Në vitin 2024 janë organizuar 4 sesione informuese me prindërit e komuniteteve për lehtësimet që ofrohen me UA për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore me qëllim të informimit të prindërve të komuniteteve rom dhe ashkali për të regjistruar fëmijet në institucionet parashkollore. Sesionet janë mbajtur në 4 komuna, në 7 qendra mësimore si: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Istog. **Konkluzioni: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur, vetëm në 2023 dhe 2024.**

12. Rishikimin/plotësimin e teksteve shkollare të Shoqërisë dhe mjedisit përmes qasjes së përfshirjes së dimensioneve kulturore dhe historike të komuniteteve jo-shumicë, me qëllim të eliminimit të gjuhës përjashtuese dhe diskriminuese: Në vitin 2022, janë hartuar dy manuale të cilat janë aprovuar nga MASHTI për kulturën demokratike, trajtimin e bullizmit në shkolla dhe mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu në vitin 2022, janë organizuar trajnime nëpër shkolla ku janë prezan-

tuar manualët. Në vitin 2023, MASHTI ka përkrahur hulumtimin mbi gjuhën e përdorur në tekste shkollore. Lidhur me këtë aktivitet edhe Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka realizuar dhe publikuar raportin Ex-officio për gjuhën e përdorur në tekstet mësimore të arsimit të mesëm të ulët, në gusht të vitit 2023. Në këtë raport të IAP është konstatuar që tekstet nuk janë diskriminuese. Tutje, IAP ka adresuar tek MASHTI e-mailin njoftues, që të njëjtin hulumtim do ta vazhdojnë edhe për tekstet e klasave 10, 11 dhe 12. Në vitin 2024, është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi mes MASHTI dhe OJQ VoRAE për hartimin e materialeve mësimore për historinë, traditat dhe kulturën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe këto materiale do të përfshihen si shtojcë e materialeve mësimore, kurse me rishikimin e teksteve të njëjtat materiale do të përfshihen në tekstet e rishikuara. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

13. Përgatitja e materialeve e teksteve që mund të ndahen si module të veçanta për historinë dhe kulturën e komuniteteve rom dhe ashkali në lëndë zgjedhore, ka shënuar rezultat në vitin 2022 dhe 2023. Një propozim për një program mbështetës u zhvillua nga projekti INCLUDE. Është zhvilluar një program trajnimi mbi krijimin e një komuniteti të të nxëniet demokratik dhe gjithëpërfshirës në shkollë dhe më pas është akredituar nga MASHTI. Po ashtu, dy manuale, një për mësuesit dhe drejtorët e shkollave dhe një tjetër për trajnuesit janë zhvilluar dhe botuar në shqip, anglisht dhe serbisht. Në vitin 2023, në bashkëpunim me OSBE është hartuar një doracak për Ndërkulturalizmin në Arsim dhe lidhur me këtë do të organizohen edhe trajnime me mësimmhënësit. Ndër të tjera, janë hartuar edhe këto module nga MASHTI: Parandalimi i diskriminimit në shkollë; Promovimi i barazisë gjinore; Parandalimi i gjuhës së urrejtjes; Parandalimin e dhunës në familje; Parandalimi i trafikimit të fëmijëve; Parandalimi i ngacmimeve seksuale; Programi i iniciativës së të rinjve-“Y Rinia”; Parandalimi i martesave të hershme; Parandalimi i punës së fëmijëve. Në vitin 2024, lidhur me këtë aktivitet është raportuar vetëm marrëveshja e MASHTI e nënshkruar me VoRAE. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur por i ngjashëm me aktivitetin e mësipërm.**

6.1.SFIDAT NË ZBATIM

1. Lidhur me aktivitetin e subvencionimit të pagesave të çerdhes për rritjen e përfshirjes të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në kopshtet e reja që do të ndërtohen në komunat me koncentrim me të lartë të komuniteteve në fjalë, duhet theksuar se një sfidë në zbatim ka qenë subvencionimi pagesave të çerdhes për rritjen e përfshirjes të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në kopshtet e reja që do të ndërtohen në komunat përkatëse. Ky objektiv nuk ka pasur përmbushje në vitin 2022, 2023 dhe 2024, për shkak se sipas MASHTI komunat nuk kanë aplikuar për një proces të tillë. Andaj, kjo çështje që i përket objektivës specifike 1.1, për gjatë tre viteve mund të shënohet si sfidë në zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
2. Edhe funksionimi i ekipeve për parandalimin e braktisjes ka qenë një sfidë në vete, në kuptim të mosfunksionimit të tyre. Nga rezultatet e raportimit, duket se ekipet nuk funksionojnë në mënyrën e pritshme. Kështu, në vitin 2023/2024, 54 nxënës është raportuar që kanë braktisur shkollën, në nivelet nga klasa 1-12, ku nga klasa 1-9 shkollën e kanë braktisur 50 nxënës.
3. Mentorimi i nxënësve dhe studentëve rom dhe ashkali nuk ka një progres të kënaqshëm, ose mekanizmi i raportimit është jo efikas.
4. Hulumtimi i nevojave për arsimimin e të rriturve nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali mbetet një aktivitet i papërmbushur për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në vitin 2022, 2023 dhe 2024, asnjëherë nuk është paraqitur një raport i detajuar që paraqet këto nevoja.
5. Organizimi i fushatave vetëdijesuese në shkollë, lidhur me promovimin e mundësive në arsimin profesional ka qenë i varfër dhe kryesisht i mbuluar me aktivitete të OJQ-ve dhe pa një mbështetje të dukshme institucionale.
6. Organizimi i programeve të shkrim-leximit bëhet në Prishtinë, por për numrin e pjesëmarrësve nuk ka informacione të raportuara saktësisht. Ky aktivitet, pjesë që realizohet në bazë kërkesave individuale apo grupe në nivel të komunave. Janë organizuar aktivitete dhe plan programe të shkrim leximit, ku kanë përfituar 27 pjesëtarë të

komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Podujevës në vitin 2023, kurse në vitin 2022 nuk ka pasur asnjë të dhënë lidhur me aktivitetet e shkollimit. Andaj, mbetet një sfidë realizimi i kënaqshëm i këtij aktiviteti, si për nga raportimi ashtu edhe për nga realizimi. Në vitin 2024, MASHTI nuk ka raportuar ndonjë të dhënë konkrete lidhur me këtë aktivitet.

7. Rritja e përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në programet e aftësimit profesional gjithashtu ka qenë një sfidë në vete. Në vitin 2022 lidhur me këtë aktivitet nuk ka pasur të dhëna, kurse në vitin 2023 janë raportuar 19 pjesëmarrës të komuniteteve rom dhe ashkali në këto programe në komunën e Podujevës. Në vitin 2024, janë bërë hulumtimet dhe planifikimet dhe në bashkëpunim me SAVE the Children lidhur me këtë aktivitet në vitin 2024, ka filluar implementimi i projektit **“Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mire dhe të barabartë në tregun e punës”**. Përgjithësisht, aktiviteti nuk është kënaqësëm i përmbushur.
8. Një sfidë në vete, për vitin 2022 dhe 2023, ka qenë rishikimi i plan programeve teksteve ekzistuese të gjuhës rome dhe hartimi i teksteve të reja. Kjo sepse, në vitin 2022 ishte mbajtur vetëm një takim, kurse në vitin 2023 nuk ishte raportuar asnjë e dhënë, ndërsa në vitin 2024, është raportuar për një marrëveshje në mes të MASHTI-it dhe OJQ VoRAE, megjithatë, nuk është raportuar progres konkret për këtë proces, por vetëm këto aktivitete shoqëruese.
9. Sigurimi i pozitave të ndërmjetësuesve në arsim në minimum 7 komuna me koncentrim më të lartë të komuniteteve rom dhe ashkali për të ulur mosregjistrimin dhe braktisjen, dhe për të ngritur vetëdijësimin për rëndësinë e arsimit dhe kundër diskriminimit, është një aktivitet i pa realizuar në vitet 2022, 2023 dhe 2024.

6.2.REKOMANDIMET

1. Në kuptim të zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, rekomandohet të ndërmerren hapa nga institucionet, respektivisht MASHTI dhe komunat, për subvencionimin e pagesave të çerdheve, me qëllim të përfshirjes më të madhe të fëmijëve të këtyre komuniteteve në kopshte.

2. Ekipet e parandalimit të braktisjes në shkolla duhet të jenë më shumë funksionale dhe efikase në kryerjen e detyrave të tyre dhe të njëjtat të raportojnë për rezultate konkrete. Kjo deri tani nuk ka ndodhur.
3. Të raportohet në mënyrë në efikase lidhur me mentorimin e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe nga OJQ-të përkatëse që zbatojnë këtë aktivitet, duke krijuar një sistem më efikas, si për nga zbatimi ashtu edhe nga raportimi dhe monitorimi.
4. Rekomandohet të ketë një hulumtim të mirëfilltë nga OJQ-të, me mbështetje institucionale, që identifikon nevojat për arsimin e të rriturve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
5. Duhet të rritet pjesëmarrja e komuniteteve rom dhe ashkali në programet e aftësimit dhe arsimit profesional. Deri tani nuk është raportuar ndonjë aktivitet që mundëson një gjë të tillë, në mënyrë reale.
6. Nuk është realizuar aktiviteti i rishikimit të teksteve në gjuhën rome dhe hartimi i plan programeve në gjuhën rome. Ka pasur vetëm disa aktivitete shoqëruese. OJQ së bashku me MASHT duhet të raportojnë progres për realizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm në vitet e ardhshme.
7. Rekomandohet të ketë më shumë takime dhe informim lidhur me shkollimin në fëmijërinë e hershme të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. OJQ duhet ndërmarrin më shumë aktivitete të tilla promovuese që lehtësojnë dhe plotësojnë zbatimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm të Strategjisë dhe planit të veprimit.
8. Duhet të rishikohet aktiviteti i sigurimit të pozitave të ndërmjetësuesve në arsim. MASHTI, Komunat dhe OJQ përfaqësuese të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duhet të paraqesin arsyen reale se përse ky aktivitet nuk është përmbushur dhe po ashtu duhet të angazhohen për përmbushjen e aktivitetit, me qëllim të parandalimit të braktisjes.
9. Rekomandohet të organizohen më shumë fushata vetëdijësuese, me prindërit e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme dhe këto sesione duhet të ndihmohen nga OJQ-të në bashkëpunim me institucionet.

10. Disa aktivitete të raportuara, në përmbushjen e Strategjisë dhe planit të veprimit nuk e zgjidhin çështjen të cilës i dedikohet aktiviteti, por janë aktivitete më shumë shoqëruese në ndërmarrjen e veprimeve. Po ashtu, ka edhe raste që nuk është raportuar buxheti i shpenzuar.

7 Zbatimi i planit të veprimit në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale


Në kuadër të përmbushjes së objektivave: **1.Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimit profesional; 2.Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali si dhe masave stimuluese për punëdhënës dhe 3.Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara nga ligji**, në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale, përgjatë viteve 2022-2024, ka pasur progres në përmbushjen e aktiviteteve dhe planit të veprimit të dhe ky progres është parë edhe në efikasitetin e shpenzimit të buxhetit.

1. Nxitja e regjistrimit dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale konform nevojave të tregut të punës: Në vitin 2022 APRK ka arritur një marrëveshje me VoRAE, dhe organizata tjera, ku është mundësuar një informim për shërbimet e punësimit dhe aftësimit profesional. Si rezultat, në 2022 në aftësim profesional janë përfshirë gjithsej 104 persona nga komunitetet dhe atë, rom 52, ashkali 24, dhe egjiptian 28. Gjatë vitit 2023 kanë përfutur nga përfshirja në aftësim profesional në Qendrat për Arsim dhe Aftësim Profesional (QAP), gjithsej 57 kandidat, prej tyre 21 rom, 24 ashkali

dhe 12 egjiptian. Buxheti nuk është i ndarë sipas komuniteteve, mirëpo vlera e kalkuluar për personat e përfshirë në trajnime ka një kosto rreth 12000 euro. Gjatë vitit 2024, kanë përfutur nga përfshirja në aftësim profesional në QAP gjithsej 24 kandidatë, prej tyre 3 rom, 3 ashkali dhe 18 egjiptian. Buxheti nuk është i ndarë sipas entiteteve, mirëpo vlera e kalkuluar për personat e përfshirë në trajnime ka një kosto rreth 6000 euro. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.**

2. Analiza e ndikimit të subvencionimit në punësim afatgjatë të komuniteteve rom dhe ashkali në sektorin privat: Nuk është realizuar. Megjithatë, lidhur me këtë aktivitet ka pasur disa veprime të raportuara dhe që janë të ndërlidhura. Në vitin 2022, numri i përfshirë në subvencionim në pagë ishte 26 persona, prej tyre: rom 7, ashkali 10 dhe egjiptian 9. Gjatë 2023, janë përfshirë 23 persona në masën aktive; subvencionim në pagë, prej tyre 5 rom, 6 ashkali dhe 12 egjiptian. Buxheti për angazhimin e 23 personave nga gjashtë (6) muaj në subvencionim page është 23,460 euro. Gjatë 2024, janë përfshirë 16 persona në masën aktive; subvencionim në pagë, prej tyre 2 rom, 10 ashkali dhe 4 egjiptian. Buxheti për angazhimin e 16 personave nga gjashtë muaj në subvencionim page është 33600 euro. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nuk ka analizë.**

Pjesëmarrja në trajnime profesionale



3. Angazhimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në praktikë, në punë dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal: Sa i përket angazhimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në punë praktike në institucionet publike, nga APRK janë angazhuar me pagesë pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali në praktikë, në punë dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal. Në vitin 2022, përfitues ishin 3 persona, rom 1, ashkali 1, egjiptian 1. Gjatë vitit 2023 janë përfshirë 10 persona në masën aktive; praktikë në punë, prej tyre 1 rom, 5 ashkali dhe 4 Egjiptian. Buxheti për angazhimin e 10 personave nga gjashtë (6) muaj në punë praktike ka qenë 10200 euro. Gjatë 2024 janë përfshirë 2 persona në masën aktive; praktikë në punë, prej tyre 2 ashkali. Buxheti për angazhimin e 2 personave nga një vit në praktikë në punë është 4080 euro. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.**

4. Angazhimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në trajnim në punë: Në vitin 2022, kanë qenë të angazhuar 3 pjesëtarë të komunitetit ashkali në trajnim në punë. Në vitin 2023, në trajnime për punë janë angazhuar 18 pjesëtarë të komunitetit rom dhe ashkali në Komunën e Podujevës. Në këtë aspekt, nuk ka pasur raportime të tjera. Në vitin 2024 nuk ka pasur të angazhuar. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.**


5. Ndarja e shumave për komunitetet rom dhe ashkali nga fondi për grantet për vetëpunësim/ startup, me fokus fuqizimin e grave në biznes dhe punësimin: Në vitin 2022, nuk ka pasur aktivitete të raportuara. Në vitin 2023 një

(1) milion euro janë ndarë për grante nga Ministria për Komunitet dhe Kthim për OJQ që kanë projekte për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali. Në anën tjetër, dy (2) milion euro nga kjo Ministri janë ndarë për bujq dhe biznese të vogla startup dhe nga ky grant kanë përfituar 111 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në vitin 2024, nuk është raportuar rezultat për këtë aktivitet. **Konkluzion: Aktiviteti i pjesërisht dhe vetëm në 2023.**

6. Rritja e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërmjetësimit në punësim: Në vitin 2022, përfitues ishin pjesëtarët e komuniteteve në total 55, respektivisht rom 17, ashkali 33, egjiptian 25. Kurse në vitin 2023, sipas të dhënave të APRK, janë ndërmjetësuar në punësim 104 persona, prej tyre 16 Rom, 44 Ashkali dhe 44 Egjiptian. Gjatë vitit 2024 janë ndërmjetësuar në punësim 99 persona, prej tyre 22 rom, 44 ashkali dhe 33 egjiptian. Megjithatë, nuk ka të paraqitur numër të ndërmjetësuesve, siç e parashikon Strategjia dhe plani i veprimit. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

7. Sa i përket fushatës vetëdijësuese për ofrimin e shërbimeve të punësimit përmes SIMP sistemi informativ i menaxhimit të punësimit përmes kampanjave: Në vitin 2022, sipas APRK me qëllim të informimit të qytetarëve për ofrimin e shërbimeve të punësimit përmes SIMP (sistemi informativ i menaxhimit të punësimit) janë mbajtur panairt e punës, ku janë bërë edhe prezantimi i shërbimeve të punësimit dhe aftësimi profesional. Në vitin 2023, në bashkëpunim

Rritja e punësimit përmes ndërmjetësimit



me shoqata përfaqësuese të komuniteteve rom dhe ashkali, janë informuar dhe nxitur pjesëtarë të këtyre komuniteteve për t'u përfshirë dhe për të përfituar nga shërbimet dhe masat aktive të tregut të punës të implementuara nga APRK. Nuk është raportuar për statistika konkrete të përm-bushjes së këtij aktiviteti të objektivës strategjike dhe specifike 1, përveç Komunës së Podujevës, ku janë përfshirë 12 pjesëtar të komunitetit rom dhe ashkali. Në vitin 2024, është mbajtur panairi i punës, ku janë përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. **Konkluzion: Aktiviteti i përm-bushur.**

8. Sa i perkat organizimit të takimeve informuese me përfaqësues të komuniteteve rom dhe ashkali: Në vitin 2022, me datë 05.07.2022, është realizuar nga AKSP promovimi i programeve të veçanta të trajnimit për të drejtat e komuniteteve me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Europian/OSBE në Kosovë. Punëto-ria është realizuar për të inkurajuar të rinjtë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të apli-kojnë në konkursin e Policisë së Kosovës. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 30 pjesëmarrës nga ko-munitetit rom dhe ashkali. Në vitin 2023, sipas të dhënave të APRK, për aftësim profesional, VoRAE ka organizuar takime informuese në zona rurale për përfshirje të pjesëtarëve të komuniteteve në trajnime në QAP. Në vitin 2024, shumë nga zyrat e punësimit kanë pasur takime të organizuara me përfaqësues të komuniteteve. **Konkluzion: Akti-viteti i përm-bushur, jo në masën e kënaqshme.**

9. Lidhur me ngritjen e kapaciteteve të punëtore-ve social mbi rëndësinë e luftimit të diskrimi-nimit, trajtimit të barabartë dhe qasjes drejtë zgjidhjeve të qëndrueshme për përfituesit në shërbime sociale në 7 rajonet e Kosovës: Në vitin 2022 janë trajnuar mbi 60 trajner të shër-bimeve sociale familjare, të cilët do të zhvillojnë materialet/modulet dhe do të ofrojnë trajnime për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare pa dallim etnie. Gjatë vitit 2023 KPSHSF, i cili ka për mandat zhvillimin e punëtorëve social, profesio-nistëve-ofrues të shërbimeve sociale familjare, me mbështetjen e Organizatave Joqeveritare QK-RMT dhe Save dhe Children ka zhvilluar dhe orga-nizuar trajnime me 6 module.

të trajnimit pa dallim etnie, për të gjithë punëtorët socialë në Kosovë. Prej tyre 501 shqiptar, 15 serb dhe 1 nga komuniteti ashkali. Ndërsa, nga ky numër i përgjithshëm, trajnimitin e kanë ndjekur edhe 10 profesio-nist, ofrues të shërbimeve sociale familjare me aftësi të kufizuara. **Konkluzion: Aktiviteti i pa përm-bushur.**

Mbështetja Financiare të komuniteteve rom dhe ashkali përmes përfshirjes në Skemat e Mirëqenies Sociale:

Ky është një aktivitet i realizuar. **Në vitin 2022,** bazuar në të dhënat e databazës së Shërbimeve Soci-ale, gjatë vitit 2022, një numër i përgjithshëm prej 49 fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë vendosur në strehim familjar tek të afërmit, ndër-sa 3 fëmijë janë vendosur në strehimin familjar alter-nativ jashtë familjes. Po ashtu, është realizuar pagesa për Skemën e Familjeve të fëmijëve me aftësi të kufi-zuara të përhershme 1-18 vjeç për 113 fëmijë të komu-niteteve rom, ashkali, egjiptian me pagesë mujore 100 euro. **Në vitin 2023,** bazuar në të dhënat e databazës së Shërbimeve Sociale, një numër i përgjithshëm prej 74 fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjipti-an janë vendosur në strehim familjar brenda familjes tek të afërmit, ndërsa 5 fëmijë janë vendosur në stre-himin familjar alternativ jashtë familjes. Nga gjithsej 74 fëmijë, 21 janë rom, 30 ashkali, 23 egjiptian, është rea-lizuar pagesa mujore është 150 euro, në muaj për një fëmijë. Tek strehimi familjar alternativ jashtë familjes janë të strehuar 5 fëmijë të komunitetit rom dhe pa-gesa mujore për këta fëmijë gjatë vitit 2023 është rea-lizuar 350 euro në muaj. E njëjta situatë është edhe me strehimin familjar alternative, jashtë farefisit, deri në qershor janë paguar 250 në muaj, nga qershori 2023 350 euro në muaj, buxheti i shpenzuar është 18,500 euro. Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetin rom dhe ashkali, në strehim familjar brenda familjes është i përcaktuar në planin e veprimtimit të Strategjisë ndër-sa buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2023 114,700 euro, meqenëse deri në muajin qershor 74 fëmijë në stre-him familjar brenda familjes janë paguar 100 euro në muaj, ndërsa nga qershori ka filluar pagesa me rritje 150 euro. Po ashtu është realizuar pagesa për Skemën e Familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme 1-18 vjeç, për 122 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, me pagesë mujore 100 euro në muaj. Nga numri i përgjithshëm, përfitues janë 122 fëmijë, tyre rom janë 38 fëmijë, ashkali 62 dhe egjipti-an 22 fëmijë. Buxheti i shpenzuar vetëm për komuni-tetet rom, ashkali dhe egjiptian për vitin 2023 është 146,400 euro.

Gjatë vitit 2024, një numër prej 74 fëmijëve të komu-niteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë vendosur në

Në total, gjatë viteve 2023 dhe 2024, janë trajnuar gjithsej 517 ofrues të shërbimeve sociale dhe famil-jare të sektorit publik dhe jo qeveritar, me 6 module

strehim familjar brenda familjes tek të afërmit. Nga gjithësejt 74 fëmijë, 20 janë rom, 28 ashkali, 26 egjiptian, pagesa mujore është 150 euro, në muaj për një fëmijë. Në strehim familjar alternativ jashtë familjes aktualisht nuk ka nga këto komunitete. Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetin rom, ashkali egjiptian, në strehim familjar brenda familjes është në plan të veprimit ndërsa buxheti i shpenzuar për këtë skemë gjatë vitit 2024 është 133,200 euro. Po ashtu është realizuar pagesa për Skemën e Familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme 1-18 vjeç për 130 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian me pagesë mujore 120 euro në muaj. Nga numri i përgjithshëm 130 fëmijë: rom janë 40 fëmijë, ashkali 65 fëmijë, dhe egjiptian 25 fëmijë. Buxheti, i planifikuar për këtë skemë është paraparë në plan të veprimit, ndërsa buxheti i shpenzuar vetëm për komunitetin rom, ashkali, egjiptian për vitin 2024 është 187,200 euro. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

Lidhur me ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes institucionale për komunitetet: Në vitin 2022, janë ofruar shërbime rezidenciale 24-orëshe për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara nga Instituti Special në Shtime, Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë dhe (13) Shtëpi të Komuniteteve në shtrirje nëpër komunat e Kosovës. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfutur mbi 273 rezidentë/klientë të vendosur në këto institucione nga të gjitha komunitetet pa dallim etnie, e vetëm nga komunitetet rom, ashkali egjiptian janë 11. Më 2023 në kuadër të këtij aktiviteti, janë ofruar shërbime rezidenciale 24-orëshe për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara nga Instituti Special në Shtime, Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë dhe trembëdhjetë (13) Shtëpi të Komuniteteve në shtrirje nëpër komunat e Kosovës. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfutur mbi 275 rezidentë të vendosur në këto institucione nga të gjitha komunitetet pa dallim etnie. Nga komunitetet rom, kanë përfutur 8 rezident, 7 në institucione rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara, me prapambetje mendore dhe 1 (një) në shtëpinë për persona të moshuar, ndërsa nga komuniteti ashkali, egjiptian nuk ka pasur përfutues për vitin 2023. Në vitin 2024, në kuadër të ofrimit të shërbimeve, janë ofruar shërbime rezidenciale 24-orësh për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara nga Instituti Special në Shtime, dhe Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë dhe (13) Shtëpi të Komuniteteve në shtrirje nëpër komunat e Kosovës. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfutur mbi 275 rezidentë/klientë të vendosur në këto institucione nga të gjitha komunitetet pa dallim etnie, e vetëm nga komuniteti rom, janë 8 rezident, 7 në institucione

rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara, prapambetje mendore dhe një në shtëpinë për persona të moshuar, ndërsa nga komunitetet ashkali, egjiptian aktualisht nuk ka. Nga buxheti i përgjithshëm Buxheti shpenzuar për këta persona është 96,000 euro.

Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.

1. Për sa i takon mbështetjes së OJQ-ve të licencuara nga ministria përkatëse në ofrimin e shërbimeve sociale familjare të komuniteteve rom dhe ashkali, në vitin 2022 kanë qenë 54 organizata përfutuese në shumë prej 2,304,545.10 euro. Për vitin 2023, nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk ka pasur Organizata Joqeveritare të licencuara, në ofrimin e shërbimeve sociale familjare për arsye të mos aplikimit të tyre për licencim. Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetet rom, ashkali lidhur me këtë aktivitet është për vitin 2023 ishte 100,000 euro, kurse buxhet të shpenzuar nuk ka pasur. Në vitin 2024, është një organizatë Joqeveritare e licencuar nga komuniteti rom, CONCORDIA në Prizren, që ofron shërbime sociale për rehabilitim të fëmijëve me varësi të internetit, sjellje asociale, braktisje të shkollës, këshillim dhe trajnim për prindërim. Këshillim dhe përkrahje në fuqizimin e familjes në tejkalimin e vështirësive familjare dhe socio-ekonomike. Mbështetja financiare e kësaj organizate nga MD për vitin 2024 ka qenë 17, 000 euro. **Konkluzion: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**
2. **Sa i përket nënshkrimit të 10 Memorandumeve mes OJQ dhe Strehimoreve për Fuqizimin e bashkëpunimit dhe rehabilitimin e fëmijëve:** në vitin 2022, nuk është raportuar ndonjë aktivitet të nënshkrimit të memorandumeve. Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me të gjitha strehimoret në nivel nacional, regjional. Të gjitha këto strehimore, gjatë vitit 2023 kanë strehuar dhe kanë trajtuar me shërbime të nevojshme viktimat e dhunës në familje të të gjitha moshave nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Gjatë vitit 2023, 81 viktimat të strehuara në këto strehimore janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në vitin 2024, Ministria e Drejtësisë ka realizuar kontrata për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me strehimoret e dhunës në të gjitha regjionet e Kosovës. Të gjitha këto strehimore gjatë vitit 2024, kanë strehuar dhe kanë trajtuar

me shërbime të nevojshme viktimat e dhunës në familje të të gjitha moshave dhe nacionaliteteve. 68 viktima të strehuara në këto strehimore janë nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian. Ministria e Drejtësisë, për vitin 2024 ka ofruar mbështetje financiare përmes thirrjes publike për (48) OJQ të licencuara që ofrojnë shërbime sociale familjare, ku nga numri, 48 i OJQ-ve, të licencuara, 9 janë strehimore të dhunës që strehojnë viktima të dhunës në familje pa dallim etnie dhe shuma e mbështetjes nga MD, për 48 OJQ-të e licencuara ka qenë 1,533,000.00 euro. **Konkluzion: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**

3. **Ofrimi i ndihmave sociale për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali që nuk kanë arritur të punësohen** ka vazhduar të realizohet. Rreth 3,000 familje me 14, 100 anëtarë të familjes kanë përfituar të drejtën në Skemën e Ndhimave Sociale nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian për vitin 2022. Rreth 3,000 familje nga këto komunitete kanë përfituar subvencione energjetike për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike. Në vitin 2023, 2,820 familje me 12,247, anëtar/e të familjes kanë përfituar të drejtën në Skemën e Ndhimave Sociale nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për vitin 2023. Nga gjithsejt 2,820 familje, përfutuese: rom janë 1,379 familje me 6,703 anëtar/e, ashkali janë 1,002 familje me 4,494 anëtar/e dhe egjiptian janë 439 familje me 2,050. Në vitin 2024, 2,637 familje me 12,294, anëtarë të familjes kanë përfituar të drejtën në Skemën e Ndhimave Sociale nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian për vitin 2024. Nga gjithsejt 2,637 familje me 12,294 anëtarë: rom janë 976 familje me 4,342 anëtarë, ashkali 1,241 familje me 5,980 anëtarë dhe egjiptian 420 familje me 1,972 anëtarë. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.**

4. **Sa i përket ofrimit të ndihmave emergjente për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.** Në vitin 2022 gjithsej 39 familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar nga kjo skemë. Në vitin 2023, 2,820 familje nga këto komunitete kanë përfituar subvencione për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike si dhe nga Skemat e Ndhimës Sociale. Lidhur me ndihmat emergjente gjithsej 19, familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar nga kjo skemë gjatë vitit 2023. Në vitin 2024 Gjithsej 8, familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar nga kjo skemë. Buxheti i ndarë vetëm për komunitetet rom, ashkali, egjiptian

është 10,000 euro në vit, ndërsa buxheti i shpenzuar është 1,600 euro. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.**

5. **Përsa i përket pjesëmarrjes dhe punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në punësim në institucionet publike,** ka pasur raportime të pjesshme. Në vitet 2022, 2023 dhe 2024 është krijuar mekanizmi për promovimin dhe nxitjen e punësimit, e po ashtu dhe nga ASK, në vitin 2024, janë publikuar të dhënat nga regjistrimi i popullsisë. Me miratimin e Ligjit për Zyrtaar Publik është shënuar një progres në aspektin e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në institucionet publike. Rregullorja për Pranimin e Zyrtaarëve Publik është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës me 27.10.2023. **Neni 13.4 i kësaj rregulloreje mundëson shpalljen e konkursit vetëm për komunitetet e ndër përfaqësuar.** Raportohet që Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka kërkuar që deri në fund të janarit 2024 të identifikohen dhjetë (10) pozita pune, që do të shpallen për komunitetet. Nga të dhënat e raportuara, duhet theksuar se aktualisht komunitetet në FSK përfaqësohen me 182 ushtarakë apo shprehur në përqindje 4.3%. Prej të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve, 40 janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, respektivisht 27 ashkali, 10 egjiptian, dhe 3 rom. **Konkluzion: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**
6. Një sukses në fushën e punësimit është raportuar puna e Ekipit ndërinstitucional për nxitjen e punësimit dhe një rezultat konkret ka qenë raporti i vitit 2023, i ekipit ndërinstitucional për nxitjen e punësimit, Ekip ky i menaxhuar nga ZQM/ZKM. Duke ditur Ekipi ndërinstitucional ka punuar së bashku për plotësimin e kuotës prej 10% të pozitive në institucionet qendrore, për rekrutimin më të gjerë të komuniteteve në Agjencitë e Sigurisë dhe FSK-së.
7. **Inicimi dhe promovimi i programeve të veçanta të trajnimit për të drejtat e komuniteteve:** Përkritazi me programet e lartpërmendura të trajnimit, në IKAP janë këto programe të trajnimit: **Të drejtat e njeriut në Kosovë dhe sistemi evropian i mbrojtjes së të drejtave të njeriut; Të drejtat e komuniteteve në Kosovë; dhe Hyrje në antigjipsizëm.** Gjatë vitit 2024, IKAP-i ka zhvilluar trajnimin "Hyrje në Antigjipsizëm" (trajnim njëditor) për 14 grupe të pjesëmarrësve. Këtë trajnim e kanë vijuar 350 nëpunës civil (226 femra dhe 124

meshkuj), prej tyre 93 të institucioneve të nivelit qendror dhe 257 të nivelit lokal. **Konkluzion: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**

8. Një e arritur, në vitet 2022, 2023, 2024 në fushën e punësimit ka qenë edhe miratimi i rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Neni 13 - Kuotat e rezervuara dhe masat afirmative. Kjo rregullore do të ndihmojë që pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të pranohen në sektorin publik.

7.1.SFIDAT NË ZBATIM

1. Në përgjithësi ka pasur sfida në organizimin takimeve informuese dhe në të gjitha këto vite, nuk ka pasur një përmbushje të kënaqshme të këtij aktiviteti, duke mos arritur numrin prej 15 takimeve të parapara në planin e veprimit të Strategjisë. Në rastin e këtyre takimeve apo fushatave informuese në fushën e punësimit, krijohet përshtypja që disa aktivitete ose nuk janë përmbushur ose nuk ka pasur raportim efikas.
2. Punëtoritë dhe aktivitetet në lidhje me ngritjen e vetëdijesimit në fushën e punësimit, duhet të mbahen vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
3. Lidhur me informimin dhe vetëdijësimin e komuniteteve përmes fushatave të ndryshme për mundësinë e marrjes dhe llojeve të shërbimeve sociale, nuk ka pasur ndonjë shifër ose numër të aktiviteteve informuese. Përveç se është pohuar që në kuadër të të gjitha QPS-ve ekzistojnë fletushka përkatëse dhe janë mbajtur disa takime e tryeza.
4. Sa i përket organizimit të takimeve të rregullta të Tryezave për Ndihmë në Menaxhim të Rasteve (TNMR-ve), pavarësisht obligimit ligjor për 4 takime brenda vitit, nuk është raportuar për numër të saktë të takimeve të TNMR-ve.
5. Në kuptimin e përfshirjes së grave në mbështetjen e bizneseve start up, nuk është raportuar të ketë ndonjë grua pjesëtare e komuniteteve, që ka përfituar nga kjo mbështetje. Ky aktivitet ka ngecur në kuptimin e përmbushjes.

7.2.REKOMANDIMET

1. Duhet të ketë një zbatim më gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes së komuniteteve rom dhe ashkali në trajnim në punë. Përgjithësisht ka pasur raportime vetëm për pjesëmarrje në trajnime në një komunë. OJQ-të duhet të angazhohen që në bashkëpunim me institucionet kompetente, të kenë më shumë trajnime të tilla.
2. Të ndërmerren masa konkrete më të theksuara për përmbushjen e objektivës strategjike dhe specifike 1, për përfshirjen e grave të komuniteteve rom dhe ashkali, në biznes, përmes mbështetjes dhe granteve për bizneset start up. Nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm buxheti në lidhje me aktivitetin "Ndarja e shumave për komunitetet rom dhe ashkali nga fondi për grantet për vetëpunësim/ startup, me fokus fuqizimin e grave në biznes dhe punësimin", sepse kjo ndarje është raportuar me rezultat vetëm në vitin 2023.
3. Rekomandohet që të raportohet numri i ndërmjetësuesve në punësim. Nuk ka të paraqitur numër të ndërmjetësuesve në punësim dhe për këtë duhet të merren masa konkrete institucionale.
4. Nuk janë raportuar të dhëna të sakta në lidhje me aktivitetet vetëdijësuese për ofrimin e shërbimeve të punësimit përmes SIMP sistemi informativ i menaxhimit të punësimit përmes kampanjave. Rekomandohet që Institucionet (APRK) dhe OJQ, të organizojnë fushata dhe të tilla aktivitete, më shumë sesa në këto tri vite.
5. Vlerësimi mbi gjendjen aktuale dhe potencialit të punësimit mes komuniteteve rom dhe ashkali, nuk është realizuar dhe rekomandohet që ky aktivitet të rishikohet ose të realizohet në periudhat e mëvonshme të zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit.
6. Punëtoritë dhe aktivitetet në lidhje me ngritjen e vetëdijesimit në fushën e punësimit, duhet të mbahen vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
7. Rekomandohet që të ketë më shumë aktivitete informuese për komunitetet, në lidhje me marrjen e aktiviteteve të shërbimeve sociale. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë në mes të OJQ-ve dhe institucioneve kompetente.

-
8. Rekomandohet që OJQ dhe komunitetet rom dhe ashkali të angazhohen në mënyrë më gjithëpërfshirëse, që të ketë më shumë OJQ të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.
 9. Lidhur me ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve social mbi rëndësinë e luftimit të diskriminimit, trajtimit të barabartë dhe qasjes drejtë zgjidhjeve të qëndrueshme për përfituesit, përgjatë këtyre viteve, ka qenë përfitues vetëm 1 pjesëtar i komunitetit ashkali, andej rekomandohet që të ketë një avokim më të madh nga OJQ dhe institucionet, në mënyrë që të rritet kjo pjesëmarrje.
 10. Rekomandohet që ZQM/ZKM, të publikoj për çdo vit raportet, në bashkëpunim me Ministrinë kompetente për punë të brendshme, për punësimin në institucione publike të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.
-

8 Zbatimi i planit të veprimit në fushën e shëndetësisë

Zbatimi i objektivave specifike në fushën e shëndetësisë si: 1.Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali; 2.Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit; 3.Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali; 4.Objektiva Strategjike - Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore, kryesisht janë përmbushur por ka pasur edhe sfida në zbatim.

1. Lidhur me ofrimin e mamografisë mobile në pesë komuna: Në vitin 2022, shërbimet e mamografisë mobile janë ofruar në komunat: Fushë Kosovë 144 vizita, Podujevë 4 vizita, Rahovec 392 vizita. Në këto komuna kanë përfituar edhe gratë e komuniteteve rom dhe ashkali. Në Gjiilan kanë përfituar nga ky shërbim 19 gra të komuniteteve rom dhe ashkali, kurse në Gjakovë 5. Në vitin 2023, situata qëndron si në vijim: QKMF Fushë Kosovë ka raportuar se janë realizuar 6 mamografi për gratë e komunitetit rom dhe ashkali. Nga QKMF Ferizaj janë implementuar aktivitete në ofrimin e shërbimeve të mamografisë statike, ku kanë përfituar gjithsej 15 gra rom dhe 25 gra të komunitetit ashkali. QKMF Obiliq ka raportuar se në bashkëpunim me DSHMS Prishtinë janë udhëzuar pacientet nga Komuna e Obiliqit për mamografi në QKMF Prishtinë. Sa i përket numrit të mamografive të realizuara, nuk janë raportuar të dhëna QKMF Prishtina. Nuk ka pasur ndonjë raportim nga QKMF për përfitimin e shërbimeve të mamografisë. Në vitin 2024, QKMF Obiliq kanë përfituar 20 gra të komunitetit ashkali; QKMF në Gjakovë, nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 66 gra kanë kryer mamografinë mobile. **Konkluzion: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**

2. Sa i përket realizimit të vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme: Gjithashtu ka pasur raportime nga QKMF në komunat përkatëse. Në vitin 2022, QKMF Ferizaj, numri i fëmijëve nga 0-3 vjeç të komuniteteteve

rom dhe ashkali të cilëve u është ofruar vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë është 49 fëmijë, ndërsa i grave shtatzënë 1. QKMF – Obiliq – në vizita janë përfshirë 926 fëmijë të komunitetit rom ashkali janë përfshirë në vizitat e lartëcekura. QKMF – Prizren ka raportuar se vizitat për nënën dhe fëmijën kanë përfshirë gjithsej 113 nëna dhe fëmijë të komuniteteve në fjalë. QKMF- Podujevë ka përfshirë 123 vizita dhe shërbime. QKMF – Rahovec ka realizuar 500 vizita. QKMF – Pejë kanë përfituar 19; QKMF Gjakovë -429 vizita shtëpiake; QKMF – Mitrovicë 0-3 vjet, janë vizituar 19 fëmijë. Divizioni për kujdesin parësor në MSh ka raportuar se gjatë vitit 2022 në kuadër të programit të vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë 1538, ndërsa gra shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë 206 gra. **Konkluzion: Aktiviteti pjesërisht i përmbushur.**

3. Në vitin 2023 QKMF - Fushë Kosovë ; QKMF - Podujevë; QKMF – Mitrovicë; QKMF – Pejë dhe IKSHPK –kanë raportua se janë kryer në Total: 648 vizita për nëna dhe fëmijë prej 0-3 vjet. Këto të dhëna nuk janë të ndara mbi baza etnike. QKMF Ferizaj ka raportuar se janë realizuar vizita, ku kanë marrë pjesë gjithsejtë 100 pjesëtarë të komunitetit rom dhe 86 pjesëtarë të komunitetit ashkali. Kurse në total janë raportuar 3833 vizita. QKMF Obiliq ka raportuar, se janë kryer gjithsejtë 475 vizita në këtë institucion, kurse nga komuniteti rom kanë përfituar 83 qytetarë. QKMF Pejë ka raportuar se për përmbushjen e këtij aktiviteti, janë kryer gjithsej 760 vizita, mirëpo në fletëzën e intrvistimit për vizita në shtëpi, nuk ekzistonte ndarja etnike, sipas komuniteteve ku përfshihen edhe komunitetet rom, ashkali por edhe egjiptian.

4. Në vitin 2024, vizita ku kanë përfituar pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë: QKMF Pejë, 35 vizita; QKMF Fushë Kosovë, 284 fëmijë dhe 46 gra shtatzëna; QKMF Podujevë, 67 fëmijë dhe 3 gra shtatzëna; QKMF Ferizaj, 75 fëmijë dhe 25 gra shtatzëna; QKMF Obiliq, 84 fëmijë; QKMF Lipjan 194 fëmijë; QKMF Gjakovë, 370 fëmijë dhe 59 gra shtatzëna. **Konkluzion: Aktiviteti i përmbushur.**

- 5. Nxitja e familjeve rom dhe ashkali për të ndjekur rregullisht oraret e vaksinimit:** Ky është një aktivitet shumë i rëndësishëm në fushën e shëndetësisë, edhe lidhur me këtë aktivitet kanë raportuar QKMF përkatëse. Në vitin 2022 janë mbajtur ligjërata për vetëdijësimin për të ndjekur rregullisht oraret në komunat si: Ferizaj, Obiliq, Fushë Kosovë, Rahovec, Podujevë, Gjilan dhe Gjakovë, ku janë shpërndare dhe fletushka. Gjithsej janë realizuar 143 sesione të vaksinimit mobil në 16 komuna për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në vitin 2022 QKMF-Obiliq në ligjërata kanë marrë pjesë 16 veta ndërsa vaksinim janë përfshi 56 fëmijë. Në vitin 2022 po ashtu, QKMF – Prizren ka mbajtur 2 takime nga shefi i vaksinimit në komunitetit; QKMF Rahovec - vetëm 4 familje kanë pranuar ti vaksinonjë fëmijët; QKMF – Pejë raporton se janë mbajtur 3 takime nga shefi i vaksinimit me komunitetet, me qëllim të nxitjes për vaksinimin. IKSHPK ka raportuar se -Përmes kampanjës “derë më derë” janë vizituar 9,149 fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian - Janë identifikuar si të pa vaksinuar 2,548 fëmijë (48% vajza), të cilët janë vaksinuar përmes kampanjës së vaksinimit mobil “catch-up vaccination”. - Prej tyre, 458 fëmijë janë vaksinuar me vaksinën MMR.
- 6.** Në vitin 2023, QKMF Gjilan nëpërmjet mbështetjes së organizatës Balkan Sunflower, ka bërë vizita derë me derë për vaksinimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë proces kanë qenë të përfshirë dhjetë (10) fëmijë pjesëtarë të këtyre komuniteteve, për shkak se të tjerët vaksinonjë fëmijët e tyre në sistemin shëndetësor paralel serb. Sipas të dhënave të IKSHPK, në vitin 2023, përmes fushatës derë më derë, me qëllim të vaksinimit janë përfshirë 1287 familje të komuniteteve rom dhe ashkali. Nga këto familje në këtë proces janë përfshirë 5515 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali. Nga QKMF Obiliq është raportuar se në kuadër të fushatës së vaksinimit kanë përfituar 118 rom, kurse nga QKMF në Pejë është raportuar që kjo shifër për vitin 2023, ka arritur në 154 persona, pjesëtar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në vitin 2024, në QKMF-të: Fushë Kosovë, Podujevë, Ferizaj, Pejë, Lipjan, Gjakovë, janë vaksinuar gjithsej 237 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, gjatë vitit 2024, IKShPK, në bashkëpunim me institucionet e KPSH dhe përkrahur nga UNICEF dhe organizatën Balkan Sunflower Kosova (BSFK), ka zbatuar kampanjën ‘derë më

derë’ për ndërgjegjësimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për vaksinimin e rregullt, si dhe për identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar. Përgjatë vitit janë realizuar gjithsej 6,648 vizita në terren në 14 komuna, ku janë ndarë informacione me prindërit rreth vaksinimit dhe janë kontrolluar kartelat e vaksinimit. Tutje, janë realizuar sesione informuese me prindër nga këto komunitete mbi rëndësinë e vaksinimit, të facilituara nga profesionistë shëndetësorë nga ekipet e vaksinimit. Gjithsej janë realizuar 20 sesione informuese me pjesëmarrje të 389 prindërve. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbyshur.**

- 7. Përsa i takon krijimit të Këshillit të Pacientëve,** një gjë e tillë ka ndodhur në disa komuna. Në vitin 2022, vetëm në Rahovec ishte krijuar Këshilli i Pacientëve. Në vitin 2023, sipas të dhënave të raportuara për këtë aktivitet, rezultoi që QKMF në Lipjan kanë themeluar Këshillin e Pacientëve, ku në kuadër të këtij këshilli bënë pjesë një anëtar nga komunitetet rom dhe ashkali. Njëjtë ka ndodhur edhe në QKMF në Rahovec dhe ndërkohë në proces të themelimit të këtij Këshilli, ku përfshihen edhe anëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali janë edhe dy QKMF të tjera. Në vitin 2024, Këshilli i pacientëve është themeluar në komunën e Pejës, në komunën e Ferizajt, raportohet që ky këshill është në raportim e sipër; në komunën e Obiliqit është themeluar këshilli i pacientëve; komuna e Lipjanit po ashtu e ka themeluar këshillin e pacientëve. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbyshur pjesërisht.**
- 8. Sa i përket, ligjëratave ndërgjegjësuere për promovim shëndetësorë dhe parandalimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse, ushqyeshmëri,** në vitin 2022, janë raportuar ligjërata nga institucionet së bashku me OJQ. Në vitin 2023, në QKMF Ferizaj janë mbajtur ligjërata të ndryshme për sëmundje të ndryshme ngjitëse nëpër shkollë, ku ka edhe nxënës të komuniteteve rom dhe ashkali. QKMF – Obiliq në ligjëratat e mbajtura janë përfshirë 268 pjesëmarrës. QKMF – Prizren ka mbajtur 3 ligjërata ndërgjegjësuere. QKMF – Pejë ka mbajtur 3 ligjërata ndërgjegjësuere. OJQ AMC Action for mother and children skreningu me PAP test në QMF V , ku gratë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë pas mundësinë për PAP test falas. Fushata vetëdijësuere me prindërit dhe me fëmijë me aftësi të kufizuara që janë të regjistruar në OJQ Pema. Me OJQ Syri i vizionit fushata vetëdijësuere në komunitet për Sëmund-

jet kronike Jo ngjitëse në Lagjen & shtatori, Cige Brestovike dhe Vitomiricë. QKMF – Gjakovë 13 sesione nga 20 participant. Në vitin 2023, sipas rezultateve të raportuara nga MSH, IKSHPK ka mbajtur 20 ligjërata, në përmbushjen e këtij aktiviteti. Numri total i pjesëmarrësve ishte 218 (138 burra dhe 80 gra). Ndërkohë, është raportuar që ligjërata për përmbushjen e këtij aktiviteti janë mbajtur nga QKMF-të e Gjilanit, Fushë Kosovës, Podujevës si dhe Ferizajt. Ndërkohë që QKMF në Podujevë ka mbajtur edhe një tryezë diskutimi. Në anën tjetër, QKMF Ferizaj, raportohet ti ketë mbajtur 4 ligjërata për rëndësinë e vaksinimit të fëmijëve, ku kanë marrë pjesë 20 pjesëtarë nga komuniteti rom dhe 60 nga komuniteti ashkali. Po ashtu edhe QKMF Pejë ka organizuar në bashkëpunim me Syri i Vizionit dhe AQH ku u realizuan 4 ligjërata. Në vitin 2024, IKSHPK ka mbajtur 30 ligjërata ndërgjegjësuere. Nga QKMF, Fushë Kosovë, Podujevë, Pejë, Lipjan, Gjakovë janë mbajtur 92 ligjërata ndërgjegjësuere. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

- 9. Lidhur me aktivitetin tryeza ndërgjegjësuere për pasojat e martesave dhe lindjeve të hershme, planifikimi familjar dhe IST:** Në vitin 2022, janë mbajtur tryeza dhe punëtori, në komunat: Ferizaj, Podujevë, Rahovec. Po ashtu, IKSHPK ka realizuar punëtori dy (2) ditore në katër komuna (në Fushë Kosovë, Lipjan, Gjilan Gjakovë). Në Rahovec dhe në Podujevë janë shpërndarë materiale informuese lidhur me këtë aktivitet. Në vitin 2023, tryeza të tilla dhe aktivitete që përkojnë me përmbushjen e këtij aktiviteti kanë organizuar QKMF-të në Gjilan, ku janë mbajtur tryeza dhe ligjërata; QKMF në Fushë Kosovë ka mbajtur ligjërata, siç u theksua edhe më sipër; QKMF në Mitrovicë, ka mbajtur gjithsej 5 tryeza me 120 pjesëmarrës kurse IKSHPK, është raportuar se ka mbajtur 5 tryeza. Ligjërata dhe tryeza në përmbushjen e këtij aktiviteti ka mbajtur QKMF Ferizaj, ku kanë marrë pjesë gjithsej 10 pjesëtarë të komunitetit rom dhe 30 pjesëtarë të komunitetit ashkali. Njëjtë është raportuar se ligjërata ka mbajtur edhe QKMF në Obiliq, ku kanë marrë pjesë 40 pjesëtarë të komunitetit rom, në gjithsej 3 ligjërata dhe tryeza. Në vitin 2024 IKSHPK ka mbajtur 9 trajnime 2 ditore me nxënës; QKMF Fushë Kosovë ka mbajtur tri (3) aktivitete; Aktivitete ndërgjegjësuere kanë mbajtur edhe QKMF Ferizaj, Lipjan dhe Obiliq. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

- 10. Lidhur me aktivitetin e shpërndarjes së materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues:** Ka pasur një raportim parcial, kryesisht në komuna të caktuara dhe në bashkëpunim me QKMF. Në vitin 2022 materiale informuese janë shpërndarë, në Podujevë, Gjilan, Viti etj. Po ashtu, janë mbajtur edhe ligjërata dhe aktivitete të ndryshme lidhur me këtë aktivitet. QKMF – Podujevë ka shpërndarë materiale informuese dhe komunikim direkt në komunitetin në fjalë mbi planifikimin dhe shëndetin riprodhues si dhe temat: mbrojtja për COVID 19, planifikimi familjar, higjiena etj dhe janë shpërndarë 86 fletushka. QKMF – Gjilan -Është bërë shpërndarja e fletushkave edhe për komunitetet rom dhe ashkali mbi planifikimin familjar nga grupi i edukimit pranë QKMF/së. QKMF–Gjakovë -Takimet në komunitet gjatë muajit tetor 2022, prezantimi i ligjërates, shpërndarja e broshurave dhe caktimi i terminit për mamografi dhe PAP test. Në vitin 2023, me qëllim të përmbushjes së këtij aktiviteti, të objektivës specifike 2, MSH ka raportuar se Komisioni Edukimit Shëndetësor në IKSHPK ka bërë shqyrtimin dhe aprovimin e materialeve, ndërsa shpërndarja është bërë nga donatorët dhe kujdesi parësor shëndetësor - të dhëna nga IKSHPK. Në linjë me këtë, QKMF Obiliq ka raportuar se janë shpërndarë 400 copë materiale informuese. Në vitin 2024, IKSHPK ka shpërndarë, 225 broshura për shëndet seksual riprodhues janë shpërndarë për nxënësit e trajnuar. Nuk ka pasur broshura të shpërndara nga QKMF-të. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**
- 11. Lidhur me fushatën ndërgjegjësuere për rëndësinë e imunizimit të rregullt (shpërndarja e fletushkave dhe organizimi i ekipeve mobile):** Në vitin 2022 QKMF – Ferizaj janë mbajtur 4 ligjërata me grupe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe organizimi i tre ekipeve mobile për vaksinimin në dy lagjet e qytetit të banuara me qytetarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. QKMF – Fushë Kosovë ka raportuar se janë mbajtur 10 fushata të vaksinimit në komunitet, prej tyre 3 derë me derë, dhe 7 në qendrën e komunitetit. QKMF – Podujevë ka raportuar se janë shpërndarë 39 fletushka informuese, kundër covid 19. IKSHPK ka realizua dy trajnimeve me përfaqësues të komuniteteve rreth vaksinimit të rregullt dhe vaksinimit kundër COVID-19. Po ashtu, IKSHPK ka realizuar ligjërata dhe sesione informuese me prindër nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me rëndësinë e vaksinimit,

gji dhënies si dhe kontrolleve rutinë, sesione mobile të vaksinimit. QKMF–Gjakovë - Mbledhja e komunitetit me anë të mediatorëve, rëndësia e vaksinimit, ndarja e materialeve edukuese. QKMF – Mitrovicë - Janë mbajtur 5 ligjërata, QKMF – Obiliq ka raportuar se 116 fëmijë të komunitetet janë vaksinuar me vakcina të rregullta për fëmijë. IKSHPK-Gjithsej janë realizuar 24 sesione informuese/ligjërata me prindër dhe kujdestarë ligjor në 16 komuna lidhur me rëndësinë e vaksinimit, si dhe për ushqyeshmërinë dhe kontrollet rutine. Mbi 650 prindër kanë marrë pjesë në këto sesione, të lehtësuar nga mjekë familjar nga Kujdesi Parësor Shëndetësor. Janë realizuar gjithsej 143 sesione mobile të vaksinimit për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian. **Në vitin 2023**, QKMF Fushë Kosovë ka raportuar se janë organizuar 3 tryeza ku kanë përfituar 40 persona të komuniteteve rom dhe ashkali. Ndërkaq, që MSH ka raportuar që QKMF në Obiliq, ka mbajtur pesë (5) diskutime, ku kanë marrë pjesë 102 rom. **Në vitin 2024**, QKMF në komunat: Pejë, Ferizaj, Podujevë, Obiliq, Lipjan, Gjakovë, kanë raportuar mbajtje të ligjëratave dhe shpërndarje të fletushkave. Në kuadër të mbështetjes së vaksinimit plotësues për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, IKSHPK në bashkëpunim me organizatën joqeveritare BSFK ka organizuar sesione vaksinimi në 14 komuna të ndryshme. Sipas, IKShKP, gjatë vitit 2024, gjithsej janë vaksinuar 2,154 fëmijë të moshës 0-6 vjeç të cilët paraprakisht janë identifikuar përmes kampanjës 'derë më derë'. Ndërkaq, janë identifikuar dhe vaksinuar edhe 136 vajza të moshës 12-13 vjeç me vaksinën kundër HPV-së, e cila është përfshirë në kalendarin e rregullt. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

12. **Lidhur me ofrimin e trajnimit për stafin profesionist shëndetësor për mos diskriminim në ofrimin e shërbimeve mjekësore:** Në vitin 2022 nuk është shënuar asnjë aktivitet i kësaj natyre dhe nuk është mbajtur asnjë trajnim me profesionist shëndetësor. Në vitin 2023 MSH ka mbajtur pesë (5) tryeza diskutimi me profesionistët shëndetësor (infermier) të nivelit parësor lidhur me prezantimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe e drejta për shëndet, e drejtë e njeriut e mbrojtur me Konventat Ndërkombëtare. Tryezat janë mbajtur në Kujdesin Parësor pasi që kontakti i parë i pacientit me mjekun është në nivel të kujdesit parësor shëndetësor. Po ashtu, këto tryeza janë mbajtur edhe në nivel të QKMF-ve, si: QKMF– Lipjan; QKMF –Rahovec; QKMF – Istog;

QKMF–Fushë Kosovë; QKMF–Obiliq. MSH raporton se tryezat kanë përfshirë 80 profesionistë shëndetësor të përgatitjes profesionale: kryeinfermier dhe infermiere. Në këto tryeza, kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë që vazhdohet me këtë temë prezantimin në të gjitha komunat që të përfshihet një numër sa më i madh në këto lloj trajnimesh, pasi është temë me rëndësi në punën e tyre të përditshme. Lidhur me numrin e tryezave për përmbushjen e këtij aktiviteti, raportohet se QKMF në Pejë ka mbajtur katër (4) tryeza me pjesëmarrje prej 10 veta, kurse QKMF në Obiliq ka mbajtur 6 trajnime, ku kanë përfituar 70 veta. Në vitin 2024, me qëllim të ngritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore janë mbajtur pesë (5) tryeza prezantimi dhe diskutimi me profesionistët shëndetësor të nivelit parësor me përkrahjen financiare të projektit të AQH-së, ku është bërë prezantimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Tryezat kanë përfshirë 55 profesionistë shëndetësor të nivelit: kryeinfermier dhe infermiere, kërkesa e tyre ka qenë që të vazhdohet me këtë temë prezantimin në të gjitha Komunat që të përfshihet një numër sa më i madh i infermierëve me këto trajnimesh, pasi është temë me rëndësi në punën e tyre të përditshme. Në vitin 2023-2024- janë përfshirë në **këto prezantime me këtë temë diskutimi** gjithsej 135 infermier nga QKMF – Komunale. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

13. **Organizimi i iniciativave të fushatës vetëdijesuese për të drejtat e pacientit dhe mekanizmeve përgjegjëse për ankesa të komuniteteve rom dhe ashkali drejtuar punëtorëve shëndetësor dhe pjesëtarëve të komuniteteve:** Edhe për këtë aktivitet raportimet janë të mangëta dhe pjesërisht, se i njëjti pjesërisht është realizuar. Në vitin 2022 është raportuar se QKMF – Ferizaj janë mbajtur ligjërata ndërgjegjësuere për kancerin e gjirit dhe IST nëpër shkolla, ku ka edhe nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe me gratë e komuniteteve në fshatin Dubravë. QKMF – Podujevë ka mbajtur takime edukimi direkt me ekipet mjekësore në vendbanimet ku jetojnë komuniteti lidhur me temat: kushtet higjienike sanitare. QKMF – Gjilan, së bashku me shoqatën "Gruaja Hyjnorë" është realizuar një fushatë për parandalim dhe preventim të sëmundjeve kronike dhe ushqyeshmërisë. QKMF – Gjakovë është mbajtur tryeza me 10 persona, ligjërata për Planifikimin Familjar, kancer të qafës së mitrës. Në vitin 2023, MSH raporton që janë mbajtur tryeza

me komunitetet rom dhe ashkali, ku kanë marrë pjesë qytetarë të këtyre komuniteteve. Temat që kanë dominuar në këto tryeza kanë qenë: prezantimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminim, e drejta e ankesës dhe e drejta për shëndet si e drejtë e njeriut e mbrojtur me Kushtetutë dhe Konventa Ndërkombëtare. Lidhur me këto tryeza dhe mbajtjen e tyre, MSH raporton se ato si të tilla janë mbajtur në tri (3) Komuna, respektivisht në QKMF– Lipjan; QKMF –Podujevë; QKMF – Pejë. Tryezat kanë përfshirë 50 qytetare të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian: udhëheqës i OJQ –ve, të këtij komuniteti. Po ashtu, QKMF në Pejë në bashkëpunim me PRAK, AQH, dhe Syri vizionit kanë realizuar katër (4) tryeza ku kanë marrë pjesë gjithsej 47 veta, pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali. QKMF në Obiliq ka raportua se ka mbajtur një (1) trajnim të kësaj natyre dhe kanë përfutur 25 persona, nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. Në vitin 2024, nga pjesëmarrja në „**Samitin e Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor**“ të mbajtur me 26 Nëntor në Prishtinë është përcjellur një iniciativë e tillë e fushatës vetëdijësuese tek stafi menaxherial dhe stafi tjetër i QKMF-së, por dhe nga takimet tjera të mbajtura kundër Antigjiptizmin. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

8.1.SFIDAT NË ZBATIM

1. Hulumtimi për gjendjen shëndetësore dhe kënaqshmërinë me marrjen e shërbimeve shëndetësore të komuniteteve rom dhe ashkali ka pasur sfida në zbatim dhe si i tillë nuk është realizuar asnjëherë deri më tani. Vetëm QKMF në Ferizaj ka raportuar që ka realizuar një hulumtim për kënaqshmërinë e pacientëve në vitin 2023, mirëpo jo vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
2. Lidhur me organizimin e takimeve koordinuese në mes të MSH, donatorët dhe OJQ që merren me aktivitete shëndetësore, përgjithësisht janë raportuar sfida dhe se takimet në mes të MSH dhe donatorëve nuk janë mbajtur ekskluzivisht vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Takimet me donatorë kanë qenë kryesisht të nxitura nga OJQ që përfaqësojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe si të tilla kanë ndodhur në komuna dhe në disa QKMF.
3. Lidhur me aktivitetin përkthimi i materialeve promovuese për ngritjen e ndërgjegjësimit në gjuhën rome, në vitin 2022 nuk ka pasur ndonjë

aktivitet ose material të përkthyer. Në vitin 2023 MSH nuk ka pasur ndonjë të dhënë konkrete që vërteton se është bërë përkthimi i materialeve promovuese, në ngritjen e ndërgjegjësimit në gjuhën rome, në fushën e shëndetësisë. Si rrjedhojë, ky aktivitet përgjatë vitit 2022, 2023, 2024, nuk rezulton të jetë përmbushur.

4. Një sfidë në vete ka qenë edhe raportimi i të dhënave nga QKMF, por edhe institucionet tjera përgjegjëse. Kryesisht, të dhënat nuk kanë qenë të plota. Nga raportimet për zbatimin e planit nga ana e MSH, në shumicën e rasteve nuk është raportuar shpenzimi i saktë i buxhetit.

8.2.REKOMANDIMET

1. Rekomandohet që IKSHKP në bashkëpunim me OJQ dhe shoqërinë civile që përfaqësojnë të drejtat e komuniteteve rom dhe ashkali të realizojnë hulumtimin për kënaqshmërinë e shërbimeve shëndetësore për komunitetet rom dhe ashkali.
2. OJQ e komuniteteve rom dhe ashkali duhet të angazhohen që të kenë sa më shumë fushata dhe takime me donatorë, me qëllim të zbatimit të dhe planit të veprimit.
3. Rekomandohet që të ketë materiale promovuese të përkthyer në gjuhën rome, me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit në fushën e shëndetësisë. Ky rekomandim duhet të përmbushet nga OJQ, me mbështetje të institucioneve. Në këtë aspekt, rekomandohet që komunat përkatëse, ku jetojnë komuniteti rom, të angazhojnë në stafin e tyre përkthyes në gjuhën rome.
4. MSH dhe institucionet e tjera relevante, në bashkëpunim me donatorët, me qëllim të mbështetjes së komuniteteve rom dhe ashkali, të mbajnë më shumë trajnime për stafin profesionist shëndetësor, për mos diskriminim dhe trajtim të barabartë të komuniteteve rom dhe ashkali, më qëllim të përmbushjes së objektivës specifike.
5. Të evidentohen në evidencat e QKMF-ve, me rastin e vizitave shtëpiake edhe qytetarët mbi baza etnike.
6. Të themelohet Këshilli i Pacientëve në të gjitha komunat përkatëse duke u përfshirë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

-
7. Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues është një aktivitet i pa përmbushur, i cili duhet të ndihmohet edhe nga OJQ-të, me qëllim që të përmbushet në masën e nevojshme.
-

9 Zbatimi i dhe planit të veprimit në fushën e banimit

Për përmbushjen e objektivës strategjike, në fushën e banimit, në kuadër të janë të parapara edhe objektivat specifike si në vijim: **1.Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe përcaktimi i hapave konkret për të përmirësuar sistematikisht gjendjen e banimit për komunitetet rom dhe ashkali.** **2.Vetëdijësimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zgjidhjen e problemeve të banimit.** **3.Ngritja e komoditetit dhe cilësisë së jetës së komuniteteve rom dhe ashkali, përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese si dhe infrastrukturës përcjellëse për qasje më të mirë në shërbime esenciale.** **4.Qasja e barabartë dhe përmirësimi i shërbimeve cilësore të banimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit të staft publik, përgjegjës për programet e banimit.** **5.Formalizimi i vendbanimeve joformale të komuniteteve rom dhe ashkali përmes revidimit të planeve ekzistuese urbanistike dhe përfshirjes konkrete në planet e reja urbanistike si dhe ofrimit të alternativave për riorganizimin e vendbanimeve ekzistuese.** **6.Qasja e barabartë në shërbime esenciale, përfshirë ujin, kanalizimin, shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, dhe luftimi i segregimit hapësinor si shkak i diskriminimit mjedisor në fushën e banimit.**

Objektivat strategjike dhe specifike, në fushën e banimit, në kuptim të zbatimit të planit të veprimit janë përmbushur si në vijim:

- 1. Organizimi i sesioneve informuese për komunitetet rom dhe ashkali në lidhje me programet aktuale të banimit social dhe mënyrës së aplikimit:** MMPHI ka raportuar se ka pasur takime dhe sesione përkatëse me OJQ, ku në takime ka pasur promovim të programeve të banimit social. Këto janë mbajtur kryesisht me OJQ. Megjithatë nuk janë raportuar konkretisht numri i sesioneve informuese.**Konkluzioni:Aktiviteti i përmbushur, por pa raportim të të dhënave të sakta.**
- 2. Ngritja e kapaciteteve të Komunave për përdorimin e platformës elektronike me të dhënat për banim social:** MMPHI raporton se ky aktivitet është realizuar në vitin 2023. Në muajin Maj 2023 janë trajnuar zyrtarët komunal. Me projektin e banimit social adekuat, kjo platformë është avancuar përmes E Kosova, me ç'rast me letërn-

joftim mund të merret informacioni për pronën e qytetarëve. Janë hartuar termat e referencës dhe në 2025 do të avancohet platforma. Buxheti i ndarë për 2025 është 100.000 euro. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

- 3. Krijimi i listës së nevojave me prioritet për banim social në nivelin komunal dhe qendror:** Sipas MMPHI, është një aktivitet i pa përmbushur ende. Kjo listë do të krijohet me avancimin e platformës elektronike përmes E KOSOVA dhe mund të konsiderohet si e përmbushur ose në proces të përmbushjes, për vitin 2025. **Konkluzioni: Aktiviteti i pa përmbushur deri në vitin 2024.**
- 4. Aktiviteti i ofrimit të ndihmës juridike falas për komunitetet rom dhe ashkali gjatë procesit të legalizimit përmes Agjencisë për Ndihmë Juridike, OJQ, Avokatit të Popullit etj.** Me ATRC në muajin nëntor 2024 ka filluar projekti për ofrimin e ndihmës juridike falas, në lagjen 28 dhe 29 në Fushë Kosovë, Obiliq, Gjakovë, Prizren. Ndihma juridike falas do të ofrohet për çështje pronësore. Sa i përket përfitimit nga ndihma juridike falas ndër vite, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar ndihmë nga ANJF, si në vijim: 2022-428, 2023-508 dhe 2024-420 përfitues. Duhet sqaruar se të gjithë këta persona nuk kanë përfituar vetëm për aspektin e legalizimit. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**
- 5. Organizimi i fushatës për promovimin për të drejtat e banimit të qytetarëve të Kosovës pa përjashtime:** Sipas MMPHI ka pasur organizime të kësaj natyre dhe aktivitete nga ana e OJQ VoRAE. Megjithatë, nuk është raportuar numri i takimeve dhe aktiviteteve. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**
- 6. Lidhur me krijimin e 5 grupeve mobile për asistimin e kompletimit të dokumentacionit përkatës pronësor në 15 komuna si dhe Lehtësimi i procedurave të legalizimit të pronave në nivelin lokal dhe qendror:** Komunitat në bashkëpunim me OJQ VoRAE dhe Advancing Together, SHPRK janë duke dhënë ndihmë përkatëse për kompletim të dokumentacionit pronësor. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

7. Përfshirja e komuniteteve në planifikimet për zgjidhjen e çështjeve të banimit në nivel lokal dhe qendror: Është përmbushur pjesërisht. Me hartimin e projekt Ligjit për Programet e Veçanta të Banimit është bërë një hap përpara. Deri në vitin 2024 ekzistojnë 17 programe 3 vjeçare të banimit, ku janë përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

8. Lidhur me përfshirjen në mënyre specifike e komuniteteve rom dhe ashkali në plane trevjeçare të banimit social: MMPHI raporton se në 17 programe të banimit social që kanë marrë shqyrtimin e ligjshmërisë në MMPH përmes MAPL, janë përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

9. Sa i përket përkrahjes në renovimin, rindërtimin dhe sigurimin e materialeve ndërtimore të shtëpive në nevojën parcelat vetanake të komuniteteve rom dhe ashkali, ose pjesëve të shtëpive si tualetet dhe banjat: Është raportuar se MAPL ka ndarë 3 milion euro për këtë aktivitet. Kurse, 1 Milion euro për banimin social, ku janë përfshirë përfitues 10 rom, 10 ashkali dhe 20 egjiptian, për ndërtimin e shtëpive të reja të banimit. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

10. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në vendbanimet e komuniteteve rom dhe ashkali ku përcaktohen nevojat e tilla nga studimi i fizibilitetit: Nga MMPHI raportohet se 107 shtëpi janë ndërtuar. 75% të përfituesve në këtë kategori janë pjesëtar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur pjesërisht.**

11. Hulumtimi i gjendjes së banimit lidhur me normat minimale të banimit: Sa i përket këtij aktiviteti është përmbushur përmes studimit të fizibilitetit i aprovuar në vitin 2023 dhe se kjo kërkesë është vendosur në Ligjin për Banim Social të Përbalueshëm. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

12. Pilotimi i transformimit të vendbanimit në vitin e parë 1200 m2 me 12 njësi banimi dhe 300m2 hapësirë për afarizëm dhe Promovimi i modelit për transformimin e vendbanimeve me institucionet dhe me qytetaret. VoRAE ka zhvilluar një program për transformimin e objekteve të banimit për komunitetet, por nuk janë raportuar të dhëna më shumë lidhur me këtë aktivitet.

9.1.SFIDAT NË ZBATIM

1. Në fushën e banimit nuk është raportuar saktësisht numri i sesioneve informuese lidhur me komunitetet rom dhe ashkali, sa i përket programeve aktuale të banimit social.
2. Nuk janë ofruar shifra konkrete në sa komuna janë duke asistuar ekipet mobile për të lehtësuar legalizimin e pronave në nivel lokal dhe qendror për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
3. Sipas ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit, Komunitat kanë përgjegjësi të hartojnë për periudhën 3 vjeçare në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet që janë në Komunë. Për zbatimin e tyre, sipas Ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit duhet të raportohet në çdo 31 mars të vitit vijues. Megjithatë, sipas të dhënave të MMPHI shumë pak komuna raportojnë për implementimin e projekteve në kuadër të programeve trevjeçare të banimit.
4. Po ashtu është bërë hartimi dhe aprovimi i Studimit të Fizibilitetit për Banim Social adekuat, në Republikën e Kosovës. Nga studim fizibiliteti kanë dalë këto rekomandime:
 - 4.1. Ka një mungesë të dukshme të efektivitetit dhe koordinimit nga autoritetet kombëtare/lokale, gjë që i lë përfituesit të pa informuar për mundësitë e banimit social dhe pa mbështetjen e duhur.
 - 4.2. Ndërtesat aktuale të Banimit Social janë në gjendje jo të mirë dhe kanë nevojë urgjente për renovime. Monitorimi dhe mirëmbajtja e rregullt pothuajse nuk ekziston, me ndarje të paqartë të përgjegjësisë, të stafit dhe buxheteve të alokuara.
 - 4.3. Programet tre (3) vjeçare të banimit nuk përgatiten rregullisht nga komunitetet dhe nuk raportohen në MMPHI-ja. Secila komunë, duhet të caktoj të paktën një zyrtar që do të merret me të gjitha nevojat dhe aplikimet për banim social.
 - 4.4. Ka nevojë për një sistem më të mirë të menaxhimit të të dhënave në nivel lokal për të mbledhur, mirëmbajtur dhe analizuar të dhënat e aplikantëve për banim, dhe për të përmbushur më mirë kërkesat e tyre.

- 4.5. Nevojitet më shumë financime në këtë sektor, mbështetur nga plane dhe programe të qarta zhvillimi. 95% e komunave theksuan financat si pengesën më të madhe për funksionimin apo zhvillim e sektorit të banimit social.
5. Një sfidë në vete për MMPHI do të jetë zbatimi i rekomandimeve të dala nga plani i fizibilitetit.
6. Një sfidë tjetër në fushën e banimit mbetet legalizimi i vendbanimeve të komuniteteve rom dhe ashkali si dhe transferimi i tyre, bazuar në parametrat e dhe planit të veprimit.
4. MMPHI, duhet të ndërmarrë veprime konkrete brenda kompetencave të saj, për të përmirësuar gjendjen e banimit të komuniteteve rom dhe ashkali.
5. Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, duhet të hartojnë programet 3 vjeçare të banimit, si obligim që del nga Strategjia.
6. Të trajtohen me prioritet rekomandimet që kanë dalë nga Studimi i Fizibilitetit për Banim Social adekuat, në Republikën e Kosovës, sipas të cilit ka raportuar MMPHI.

9.2.REKOMANDIMET

1. Rekomandohet që të bëhet krijimi i listës me prioritet për banimin social dhe të realizohet brenda vitit 2025-2026.
2. Vlerësohet e nevojshme të vazhdoj ndihma juridike falas për çështjet e banimit dhe ANJF, në bashkëpunim me OJQ VoRAE, Advancing Together dhe të tjerat të vazhdojnë bashkëpunimin në ofrimin e ndihmës juridike falas, me theks të veçantë në pjesën e legalizimit të banimeve.
3. Inkurajohen të vazhdojnë projektet për transformimin e vendbanimeve për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me mbështetje të donatorëve dhe OJQ si dhe përmes përkrahjes konkrete nga ana e institucioneve. Këto projekte të prioritetizohen dhe të kenë edhe mbështetjen institucionale.
7. Rekomandohet që MMPHI si institucion qendror, por edhe komunat e Kosovës të marrin me prioritet përmbushjen e obligimeve nga deklarata e Poznanit, me qëllim që të bëhet legalizimi i vendbanimeve të komuniteteve rom dhe ashkali.
8. Rekomandohet të ketë një koordinim më të qëndrueshëm në mes të nivelit qendror dhe lokal, me qëllim të zbatimit të projekteve në fushën e banimit.
9. Të bëhet përgatitja e manualit për banim adekuat social, për komunitetet rom dhe ashkali.
10. Me rastin e fillimit të zbatimit të ligjit të ri për Banimin Social dhe të Përballeshëm, MMPHI të ndërmarr masa më urgjente, në zbatimin e dispozitave afirmative të këtij ligji, përkitazi me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

10 Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit në fushën mbrojtjes nga diskriminimi

Objektivat specifike, për sa i takon fushës së mbrojtjes nga diskriminimi, lidhur me zbatimin e planit të veprimit, janë: **1. Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve; 2. Ulja e dukurisë së racizmit dhe diskriminimit dhe rritja e cilësisë së jetës për komunitetet rom dhe ashkali në mënyrë sistematike përmes zhvillimit të propozimit legjislativ për barazi, pjesëmarrje, përfshirje dhe luftimit të racizmit dhe diskriminimit; 3. Rritja e llogaridhënies dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë dhe mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës dhe dhunës së urrejtjes dhe bullizmit; 4. Rritja e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali përmes vetëdijësimit dhe ndërgjegjësimi të publikut dhe zyrtarëve publik për racizëm dhe antidiskriminim ndaj komuniteteve rom dhe ashkali si dhe promovimit të historisë dhe kulturave të komuniteteve rom dhe ashkali; 5. Mbështetja dhe avancimi i punës së Grupit Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të themeluar nga Qeveria, për të adresuar ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për diskriminim ndaj tyre, si dhe për të realizuar aktivitetet për vetëdijësimin e publikut për parandalimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto objektiva në vitin 2022, 2023 dhe 2024 janë përmbushur si në vijim:**

- 1. Sa i përket trajnimeve të zviluara me gjyqtarë, prokuror dhe avokat, në vitin 2022 ka pasur trajnime të zhvilluara në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.** Në trajnime kanë marrë pjesë gjyqtarë dhe prokurorë dhe se këto trajnime janë organizuar, si të tilla në vazhdimësi nga ana e Akademisë së Drejtësisë. Në trajnime kanë marrë pjesë 51 gjyqtarë dhe 18 staf administrativ. Në vitin 2023 janë realizuar 3 trajnime për gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional. Në vitin 2024 janë realizuar 3 trajnime, gjyqtarë, pro-

kuror dhe bashkëpunëtor profesional. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

- 2. Lidhur me identifikimin dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit:** Në vitin 2022 janë organizuar 2 trajnime, ku kanë marrë pjesë 32 pjesëmarrës. Po ashtu, trajnime të realizuara ka pasur edhe në vitin 2023, me mbështetje të organizatave jo qeveritare. Në vitin 2024 është mbajtur trajnimi për Hyrje në Antigjipsizëm. Në këto trajnime kanë marrë pjesë gjithsej 350 pjesëmarrës. Nga niveli qendror 93, dhe 257 në nivelin lokal. Femra kanë marrë pjesë 256, kurse meshkuj 124. Prej pjesëmarrësve 28 janë të nivelit drejtues të ulët dhe të mesëm, 322 janë të nivelit profesional. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**
- 3. Zhvillimi i kapaciteteve, ofrimi i trajnimeve themelore, të avancuara dhe të specializuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe racizmit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali për: Policinë e Kosovës; Shërbimin Korrektues; Shërbimin Sprovues; Doganën e Kosovës; Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; Inspektoratin Policor të Kosovës si dhe personat privat fizik dhe juridik:** Ky është një aktivitet i realizuar, kryesisht brenda kurrikulave përkatëse të institucioneve ligjzbatuese dhe në kuadër të trajnime dhe programeve të cilat akreditohen nga ana e AKSP. Në vitin 2022, AKSP ka realizuar 6 tema me 597 pjesëmarrës. 2023: Pjesëmarrës në trajnime në: Policinë e Kosovës me gjithsejtë shtatë (7) rom dhe ashkali, ndërsa tre (3) janë të komunitetit egjiptian, kurse Shërbimin Korrektues të Kosovës me një (1) pjesëtar nga komuniteti egjiptian. 2024: Gjithsejtë 28 pjesëmarrës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në trajnimet e fushëveprimtarisë policore. Të gjithë këta pjesë në trajnimin 3 muor 'Zyrtar Policor'. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

4. **Sa i përket organizimit të fushatave ndërgjegjëse për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për dhunë në familje dhe dhunën në baza gjinore.** ABGJ në vazhdimësi në vitin 2022 dhe në vitin 2023 ka organizuar fushatat ndërgjegjëse përmes videospoteve. Ritransmetimi i videospotit është realizuar në RTK dhe është biseduar që të ketë një transmetim të një videospoti të ri për vitin 2025. ZQM/ZKM në bashkëpunim ABGJ kanë përgatit dhe shpërndarë 150 fletushkat lidhje për martesë të hershme në vitin 2024. Gjithsej 150 fletushka në gjuhën shqipe dhe serbe. **Konkluzioni: Aktiviteti i përm-bushur pjesërisht.**

5. **Krijimi i mekanizmit për identifikim, parandalim, zvogëlim dhe mbrojtjen e personave, lindja e të cilëve nuk është e regjistruar, që kërkon adresim sistematik institucional.** Projektligji për gjendjen civile ka përfunduar në vitin 2022-2023. Lidhur me përm-bushjen e këtij aktiviteti, Drejtoria e Gjendjes Civile në vazhdimësi ka qenë pjesë e proceseve për lehtësimin e procedurave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në projekt ligjin e ri të gjendjes civile janë paraparë që të krijohet mekanizmi ndër-institucional për regjistrim të lindjeve dhe vdekjeve përmes kanaleve zyrtare, dhe hartimi në koordinim me komunat për parandalim dhe regjistrim të të gjithë qytetarëve të pa regjistruar. **Konkluzioni: Aktiviteti i përm-bushur pjesërisht.**


6. **Sa i përket obligimit për krijimin e platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian:**

Duhet të theksohet se kjo platformë është krijuar dhe menaxhohet nga ZQM/ZKM. Që nga vitin 2022, kur kjo platformë funksionon, është angazhuar një administrator i platformës dhe një ekspert ligjor për trajtimin e rasteve të paraqitura. Deri me 1 dhjetor 2024, në platformë janë paraqitur dhe trajtuar 52 raste, nga të cilat 18 raste janë adresuar me sukses, kurse 25 prej tyre nuk kanë rezultuar me diskriminim. Në vazhdimësi ka pasur raste të referuara në platformën kombëtare dhe se këto raste janë referuar dhe trajtuar në koordinim e Grupit teknik. **Konkluzioni: Aktiviteti i përm-bushur.**


7. **Grupi Teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian:** Ky grup ka qenë shumë funksional dhe është koordinuar me institucionet për të luftuar diskriminimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian: Ky grup, ka mbajtur takime të rregullta dhe në vitin 2022 ka mbajtur 3 takime, në vitin 2023 ka mbajtur 3 takime si dhe në vitin 2024 ka mbajtur 4 takime, përfshirë edhe tryeza. Grupi Teknik në vazhdimësi ka trajtuar dhe ka dhënë rekomandime për institucionet për luftimin e diskriminimit, përmes platformës kombëtare. **Konkluzioni: Aktiviteti i përm-bushur.**

8. **Organizimi i sesioneve dhe fushatave informuese për mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe bullizmit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali dhe OJQ.** Ky aktivitet në përgjithësi është i përm-bushur nga ZQM/ZKM. Janë organizuar sesione informuese

Rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të raportuara sipas viteve



Rastet e raportuara sipas komunës ku ka ndodhur diskriminimi



për mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës dhe dhunës së urrejtës dhe bullizmit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali dhe OJQ në nivel qendror dhe lokal gjatë muajit tetor dhe nëntor 2022, ku janë shpërndarë fletushka 500, postera 50 për qëllimin dhe përdorimin e platformës. Takimet janë organizuar 5 regjione të Kosovës. Kjo fushatë ka vazhduar edhe në vitin 2023 dhe janë transmetuar dhe videospote dhe janë mbajtur tryeza. Në vitin 2024 janë organizuar takime rajonale për prezantimin e raportit për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, ku edhe është bërë promovimi i Platformës kombëtare për diskriminimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe demonstrimi i mënyrës së raportimit në Platformë. Takimet janë organizuar: 16 prill 2024 – Prizren; 18 prill 2024 – Pejë; 22.04.2024 – Gjilan; 26.06.2024 – Prishtinë.

Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.

- 9. Lidhur me aktivitetin e promovimit dhe ndërgjegjësimin për historinë, kulturën, njohjen e komuniteteve rom dhe ashkali:** Gjatë vitit 2022 gjithsej 6 organizata/operatore kulturore të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian janë financuar nga MKRS, me shumën totale prej: 28,432.50 €.

Bazuar në të dhënat përfundimtare sipas rezultateve finale të thirrjeve publike ; Art dhe TK (konkursi i parë); Art dhe Kulturë (konkursi i dytë); Mobiliteti kulturor; Botim libri-blerje-revista-autori; të shpallura nga DK/ MKRS për vitin 2023 për përkrahjen financiare të pro-

jekt-propozimeve kulturore, gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) projekte janë përkrahur financiarisht nga fusha e artit dhe kulturës (trashëgimisë kulturore) për OJQ dhe Individ.

Shuma e gjithmbarshme për subvencionimin e projekteve për vitin 2023 (OJQ dhe Individ) është: 101,700.00 €.

Përkrahja e MKRS ka vazhduar edhe në vitin 2024, me subvencionimin e projekteve të ndryshme të OJQ dhe individ për promovimin dhe ndërgjegjësimin për historinë, kulturën, njohjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Gjatë vitit 2024 gjithsej 13 organizata/operatore kulturore të komuniteteve rom dhe ashkali dhe egjiptian janë financuar nga MKRS, me shumën totale prej me 120.100,00€

Në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, sipas të dhënave të MKRS janë organizuar edhe: 1.Organizimi i aktiviteteve kulturore-artistike gjithëpërfshirëse: shfaqjet muzikore, teatrore, folklorike, aktivitete pamore-eksponat, baleti, filma dokumentar, panaire me artizanale, gatime dhe prezantimi i ushqimeve si vlerë kulturore; organizimi i debateve, tryezave të rumbullakëta, trajnime mbi tematika të ndryshme, vetëdijësuese sipas interesit; 2.Organizmi i manifestimeve kulturore për nder të ditës së flamurit të k-rom (Dita Ndërkombëtare e romëve 8 prilli) dhe Dita e flamurit kombëtar të k-ashkali 15 shkurti; ku përmes këtyre manifestimeve do të kontribuohet në promovimin e komuniteteve në fjalë si dhe në ruajtjen e kultivimin e identitetit kulturor e atë kombëtar në vend; 3.Përkra-

hja e aktiviteteve në fushën e trashëgimisë kulturore: mbi kulturën, gjuhën, historinë, traditat dhe zakonet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; 4.Përkrahja e aktiviteteve në fushën e publikimeve (botimi i librave, revistave, përkthime në/nga gjuha rome, pasurimi i bibliotekave/literature); 5.Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve në sport të komuniteteve rom dhe ashkali; 6.Përkrahja e aktiviteteve në fushën e rinisë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian; 7.Përkrahje të aktiviteteve kulturore dhe shënim të ditëve të veçanta të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

10. Promovimi i historisë dhe kulturës së komuniteteve rom dhe ashkali përmes emisioneve nacionale televizive me pjesëmarrës zyrtar publik komunal/përfaqësues politik: Ky aktivitet, si i tillë është pjesë e mandatit ligjor të ZQM dhe ZQM na vazhdimësi ka mbajtur aktivitete promovuese, duke u paraqitur në emisione të ndryshme, ku temë ka qenë promovimi i kulturës dhe historisë së komuniteteve rom dhe ashkali. Megjithatë, nuk është raportuar ndonjë statistikë për përmbushjen e këtij aktiviteti. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

11. Ngritja e kapaciteteve për PSV dhe BPGJ përmes trajnimeve, si aktivitet është përmbushur: Në vitin 2022-2024 është raportuar se MAPL në bashkëpunim me UN WOMAN ka hartuar 16 plane të veprimit (Procedurat Standarde të veprimit). Po ashtu është raportuar se janë mbajtur trajnime për ngritjen e kapaciteteve për Procedurat Standarde të Veprimit dhe trajnime për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

12. Zyra për Qeverisje të Mirë, në vazhdimësi ka punuar për zbatimin e planit të veprimit. Në muajin shtator dhe tetor 2024, ZQM/ZKM në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe projektin Roma Integration III, është rishikuar plani i veprimit për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, për vitet 2025 dhe 2026. **Konkluzioni: Aktiviteti i përmbushur.**

13. Një tjetër çështje e ndërlidhur me mbrojtjen nga diskriminimi janë martesat e hershme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për të luftuar këtë dukuri negative në shoqëri, është themeluar Grupit punues ndërinstitucionalë për parandalimin dhe raportim të martesave të

hershme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me Vendimin e Qeverisë nr. 41/178 të datës 13.12.23. Në kuadër të këtij grupi janë duke u bërë hulumtime dhe plane të veprimit për ndalimin e martesave të hershme të këtyre komuniteteve si dhe janë duke i trajtuar rastet që janë paraqitur të kësaj dukurie.

14. Një aktivitet i rëndësishëm për mbrojtjen nga diskriminimi, është realizuar me 26 nëntor 2024 dhe ky aktivitet ka të bëjë me **konferencën e Ballkanit Perëndimor kundër diskriminimit racor**. Konferenca është hap nga Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë vendet e Ballkanit Perëndimor ku janë botuar rekomandimet e samitit që trajton edhe temën e diskriminimit.

15. Nga ZQM/ZKM, po ashtu, është publikuar edhe raporti për zbatimin e deklaratës së Poznanit.

16. Në vazhden e përpjekjeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt avancimit të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, nga Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Bashkimin Evropian është organizuar seminari e përbashkët me temën **“Politikat për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë”** më 05 Qershor 2024.

17. Në kuptim të përmbushjes së dhe Planit të Veprimit, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Ministrinë Administrimit Pushtetit Lokal, dhe në mbështetje të OSBE-së ka organizuar takimin komunal për zbatimin e politikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me Komitetet Komunale Veprimit më 28.03.2024. Ky takim ka bashkuar zyrtarët në nivel qendror dhe lokal, me qëllim të informimit dhe diskutimit të zbatimit dhe monitorimit të politikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me Komitetet Komunale Veprimit.

18. ZQM/ZKM ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale e Strehimit të Romëve në Tiranë më 12-13 Qershor 2024 e organizuar Roma Integration Project III.

19. Po ashtu në kuadër të aktiviteteve dhe përmbushjes së dhe planit të veprimit është organizuar “Tryeza e rrumbullakët për mentorimin e studentëve në universitete nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian” nga Zyra për Qeverisje të

Mirë/Zyra e Kryeministrit me koordinim e Këshilltares Elizabeth Gowing. Ky aktivitet është mbajtur më 27.03.2024.

10.1.SFIDAT NË ZBATIM

1. Nuk është raportuar që të jenë realizuar trajnime për noter, administrator dhe falimentues, sepse kjo bëhet me kërkesë të profesioneve të lira.
2. Lidhur me aktivitetin organizimi i fushatave ndërgjegjëse për vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe zyrtarëve publikë për racizëm dhe antidiskriminim ndaj komuniteteve rom dhe ashkali, ABGJ ka raportuar që ky aktivitet është bartur në vitin 2025 sepse nuk është realizuar në vitet 2022, 2023 dhe 2024.
3. Lidhur me aktivitetin, organizimi i trajnimeve për vetëdijësim të nëpunësve civil rreth rëndësisë së tolerancës dhe përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali në shoqëri, ABGJ ka raportuar që ky aktivitet është bartur në vitin 2025 për t'u realizuar.
4. Në përgjithësi, aktivitetet që lidhen me objektiven e për mbrojtje nga diskriminimi, kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe një pjesë e tyre ka nevojë të rishikohen dhe konkretizohen. Në rastin konkret, aktivitetet e promovimit dhe evokimit si të tilla, duhet të përmbledhen në një aktivitet të vetëm.
3. Inkurajohen të vazhdojnë me ndërmarrjen e fushatave për promovimin më të theksuar të Grupit Teknik për të Drejtat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të përmbushjes së zotimeve që dalin nga deklarata e Poznanit.
4. Inkurajohen të vazhdojnë me veprime avokuese, të cilët shërbejnë për promovimin sa më të gjerë të Platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
5. Inkurajohen të vazhdojnë kompetentët të ndërmarrin më shumë fushata avokuese, për vetëdijësimin e komuniteteve rom dhe ashkali në raportimin e rasteve të diskriminimit.
6. Inkurajohen të vazhdojnë ndërmarrja e më shumë veprimeve konkrete për luftimin e gjuhës së urrejtjes, për komunitetet rom dhe ashkali.
7. Organizatat e shoqërisë civile dhe ZQM/ZKM, përmes takimeve me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, inkurajohen të vazhdojnë që të raportojnë në mënyrë jo anonime rastet e diskriminimit të tyre, në platformën kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
8. ZQM dhe shoqëria civile, në vitet pasuese, të ndërmarrin një seri të takimeve avokuese, me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për të vetëdijësuar pjesëtarët e komuniteteve në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi dhe raportimin e tij.

10.2.REKOMANDIMET

1. Sa i përket trajnimeve që do të mbahen për zyrtarët publik për nëpunës civil, rekomandohet që trajnimet të fokusohen në luftimin dhe parandalimin e diskriminimit.
2. Nevojitet koordinim më i theksuar në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve për nxitjen e raportimit të diskriminimit, në platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
9. ZQM dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të përgatisin një plan vjetor avokues, për të promovuar vlerat historike dhe kulturore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin ndaj tyre.
10. Duhet të vazhdojë në baza vjetore të mbahet samiti i Ballkanit përëndimor kundër diskriminimit racor.

11 Ndikimi i dhe planit të veprimit në avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Kosovë dhe ndërlidhja me deklaratën e Poznanit

Përgjithësisht nga të dhënat e raportuara për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komunitetit rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024, vërehet se ka pasur një progres dhe kujdes lidhur me avancimin e të drejtave të këtyre komuniteteve në Kosovë, bazuar në përcaktimet e deklaratës së Poznanit, me qëllim të integritetit të romëve.

Nuk ka dilemë që përfundimet, në lidhje me përm-bushjen e objektivave të dhe aktiviteteve të Planit të veprimit, duhet të shikohen, në kuptim të matjes së tyre, me përcaktimet e deklaratës së Poznanit.

Në lidhje me rritjen e shkallës së punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali, në sektorin publik, si objektivë e deklaratës së Poznanit, vlen të theksohet që viti 2023, ka pasur një zhvillim të rëndësishëm, për shkak të miratimit të Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për punësimin e Zyrtaresve Publik, e cila përcakton kuotat e punësimit për komunitetet në Republikën e Kosovës dhe vendet e garantuara në sektorin publik.

Lidhur me banimin, bazuar në përcaktimet e deklaratës së Poznanit, Qeveria e Kosovës, respektivisht MFPT, kanë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare, e cila ka për qëllim sigurimin e strehimit të komuniteteve rom dhe ashkali dhe në këtë kuptim kjo marrëveshje ndërkombëtare, e raportuar nga MMPHI, pritet të përmbushë në shkallë të theksuar përcaktimin e deklaratës së Poznanit.

Lidhur me çështjen e arsimit, Institucionet e Kosovës, respektivisht MASHTI dhe institucionet lokale, kanë bërë përpjekje maksimale për integrimin e romëve dhe ashkalive, me qëllim të sigurimit të procesit mësimor, mësimi alternativ ose minimizimit të ç'rregjistrimeve nga shkollat. Megjithatë, mbetet që edhe përgjatë viteve tjera të vazhdohet me punë intensive, në mënyrë që shkalla e braktisjes së shkollave të zvogëlohet dhe të rritet 90% shkalla e regjistrimit, në arsimin fillor dhe 50% në arsimin e mesëm.

Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera vartëse, kanë vazhduar që të mbështesin në mënyrë të theksuar zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, në vitet 2022, 2023, 2024. Megjithatë mbetet që të punohet në drejtimin e hartimit të ligjeve të veçanta, me qëllim që të mbulimit të sigurimit shëndetësor, siç e kërkon deklarata respektive.

Në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, janë bërë hapa të rëndësishëm në vitin 2022, 2023, 2024. Adresimi i rasteve nga Grupi Teknik dhe Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ka përmbushur në nivel të lartë mbrojtjen nga diskriminimi të këtyre komuniteteve, si përcaktim i deklaratës së Poznanit. Në vitin 2023, për herë të parë, në kuadër të rasteve të raportuara në Grupin Teknik, me aktgjykim të gjykatës kompetente është arritur mbrojtja nga diskriminimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Platforma Kombëtare, përgjatë viteve 2022, 2023, 2024 ka arritur të adresoj me sukses mbi tetëmbëdhjetë (18), raste që kanë pasur për objekt mos diskriminimin, nga 52 në tërësi, sa janë raportuar deri në vitin 2024.

Si përfundim, të arriturat kryesore në zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024, janë:

Fusha e Arsimit:

- Regjistrimi i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian, në institucionet shkollore publike;
- Regjistrimi i qendrave mësimore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
- Mbështetja financiare e qendrave mësimore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Ndarja e bursave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Mentorimi i studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Punësimi dhe Mirëqenia Sociale:

- Nxitja dhe pjesëmarrja në trajnime e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për nevoja të tregut të punës;
- Subvencionimi në pagë;
- Angazhimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në praktikë në punë;
- Rritja e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes ndërmjetësimit;
- Mbështetja financiare përmes përfshirjes në skemat sociale.

Fusha e Shëndetësisë:

- Ofrimi i mamografisë mobile;
- Realizimi i vizitave shtëpiake;
- Shtimi i numrit dhe pjesëmarrja në vaksinim;
- Mbajtja e aktiviteteve promovuese dhe ndër-gjegjësuere në fushën e shëndetësisë, ku përfitues kanë qenë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Fusha e Banimit:

- Studim Fizibilitetit për Banim Social Adekuat në Kosovë (UN-Habitat);
- Studim Fizibiliteti për Banim të Përballueshëm (IFC);
- Miratimi i Ligjit për Banimin Social dhe të Përballueshëm në lexim të parë dhe të dytë, me 05.12.2024, i cili ka përfshirë në masa afirmative edhe **komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**;
- Miratimi i Ligjit Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës për kredi 25 milion euro;
- WBIF - Grant 2 milion euro për Asistencë Teknike për implementimin e projektit.
- Hartimi i termave të Referencës për Regjistrin Elektronike të Banimit Social dhe të Përballueshëm;
- Thirrja për shprehjen e interesit për projektin e Banimit Social Adekuat në Komunat e Republikës së Kosovës, e hapur në 2024;

- Nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit me 27 Komunat (Prishtina, Mitrovica e Veriut, Drenas, Zubin Potok, Dragash, Shtime, Kamenicë, Malishevë, Skenderaj, Ferizaj, Mamushë, Gjilan, Peja, Hani i Elezit, Mitrovica e Jugut, Klinë, Lipjan, Fushë Kosovë, Istog, Vushtrri, Deçan, Junik, Gjakovë, Podujevë, Novobërdë, Obiliq, Rahovec) që kanë shprehur interes për Projektin e Banimit Social Adekuat, në 2024;
- Themelimi i Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP);
- Angazhimi i Ekipit të ekspertëve për projektin e Banimit të Përballueshëm dhe Social;
- Thirrja publike për ndarjen e lokacioneve për Komuna, në vitin 2024 dhe përgjigjja e thirrjes publike nga **13 Komunat e Kosovës**, vlerësimi i aplikacioneve dhe hartimi i termave të referencave;
- Hartimi dhe dorëzimi i **Projekteve ideore** në komunat Pejë, Gjilan, Podujevë, Kamenicë, Istog dhe pajisja me Kushte ndërtimore;
- Hartimi dhe dorëzimi i **Projekteve kryesore** në komunat Pejë, Gjilan, Podujevë, Istog dhe në proces pajisja me **Leje ndërtimore**;
- Janë hapur në tender projektet për banimin e përballueshëm dhe social në 4 komuna.

Mbrojtja dhe luftimi i diskriminimit:

- Themelimi dhe funksionalizimi i platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Themelimi i grupit punues kundër martesave të hershme;
- Hartimi i raportit për zbatimin e deklaratës së Poznanit;
- Realizimi i samiteve dhe aktiviteteve tjera për mbrojtjen nga diskriminimi dhe luftimin e tij;
- Hartimi i projektligjit të ri për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- Rishikimi i planit të veprimit për zbatimin e për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2024.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen. Opinionet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Të gjitha kërkesat për riprodhimin ose përkthimin, të plotë apo të pjesshëm, të këtij dokumenti duhet të drejtohen te Programi i Integritetit të Romëve – Faza III (roma.team@coe.int).

www.europa.eu

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës